



SUPLEMENTI "RILINDASI" EKSKLUZIVE ▶ Faqe 13-20

Takimet në SHBA të Ahmet Zogut për të rrëzuar Enver Hoxhën

Dokument i sekret/ Plani i operacionit të koduar "Apple", 30 mijë burra për kryengritjen



Trashëgimia kulturore Majlinda Bregu ndërtime në kalanë e Prezës. Shkreli: Shkelje

▶ Faqe 6-7

[SHQIPTARJA.com]

LEKË 30 SHQIPTARJA.com + Suplementi "RILINDASI"

VITI III - NR. 165 E diel, 14-07-2013

NA NDIQNI EDHE ONLINE
www.shqiptarja.com
...origjina e lajmit...

PIKTORI-KRYEMINISTER

Rrëfimi i pazakontë: Koncepti për vdekjen? Ishte konfidencial

EDI RAMA "ME NGJYRAT E PS DHE PD KRIJOVA RILINDJEN"

- Francesco Bonami i Bienale 2003: Kaosi i Shqipërisë? Bast i madh për Edi Ramën
- Kreu i PS: Ato që mund të legalizohen, do t'i legalizojmë, të tjerat do t'i prishim

▶ Speciale në faqet 2-3

NË FOTO: Kreu i PS-së Edi Rama dhe mbrapa tij një prej pallateve të lyera me ngjyra të ndryshme në kohën kur ishte kryetar i bashkisë së Tiranës



Koment



NGA AFRIM KRASNIQI

Në kohën e gabuar?

Në bisedë me një gazetar gjerman që mbuloi zgjedhjet në Shqipëri mora një pyetje, për të cilën e kam gjithnjë e më të vështirë të përgjigjem. A kanë respekt shqiptarët për dijen dhe librin? Në tekstet shkollore jemi rritur duke thënë PO. Në konferenca, botime apo aktivitete me ngjyrë patriotike gjithashtu themi PO. Dhe ilustrime të etër kulturor të Rilindjes apo para-rilindjes, ata që krijuan shkrimin e librit shqip, ata që më vonë bënë emër në krijimtarinë e tyre profesionale, deri tek brezi i Kadarese apo disa dhjetëra krijuesve të rinj që kanë arritur sukses në shoqëritë e sotme perëndimore ku jetojnë! Një bilanc i bukur për alibi! Por për gazetarin... ▶ vijon në faqe 22

Koment



NGA ERION KRISTO

Kush e trazon e përjetësinë?

Në na ka kapur "Sindroma e Skrapit". Cdo gjë e mundshme shndërron në material të shitshëm dhe të riciklueshëm. Nuk e kemi pas ditur që kemi brenda vetes këtë ndjenjë të pangopur riciklimi, që shkon deri te cenimi i monumenteve në sheshet qendrore të vendit. Dhe kjo mani që na ka mbërthyer me thonjtë e saj të hekurit shfaqet në forma krejt makabre, që shkojnë deri te cenimi dhe vjedhja e varreve, dukuri kjo që është shtuar së fundi.

Nuk thonë kot ata që e njohin botën, se qytetërimi i një vendi duket te varrezat. Dhe për këto nuk mburremi dot, jo thjesht sepse janë një shëmti e vërtetë, sidomos ato qytetësit, por sepse... ▶ vijon në faqe 22

MANDATI

▶ Faqe 9



PR padit PD: Na grabitën një deputet

KRIMI NE FAMILJE

▶ Faqe 4-5



Sherri për vajzat Burri vret gruan në mes të Tiranës

FIDEL YLLI:

▶ Faqe 22



I gatshëm t'i shërbej sportit në çdo pozicion

PRAPASKENAT E DEBATEVE

Blendi Fevziu: Si u prisha me Berishën


"Me Ramën kam organizuar emisionin më të mirë të fushatës zgjedhore"

NERANXI
... gjithmonë një hap përpara...
Lëndë të para për restorante, piceri, kreperi dhe fast food.

TIRANE

NGA ANILA BASHA

Për moderatorin e "Opinion" Blendi Fevziu, është ngritur një thashethem-najë e tërë poshtë e përpjetë, para dhe pas zgjedhjeve. Duke qenë se ka... ▶ Faqe 12





Kreu i PS

RRËFIMI ndryshe i Edi Ramës për Corriere della Sera: Si do ta bëj Shqipërinë të bukur



NË FOTO: Pamje nga filmi 15 minuta "Dammi i colori" i Anri Salës dhe Edi Ramës prezantuar në Bienalen 2003 të Venecias. Qyteti gjatë natës pikturoar me ngjyra me rrëfimin me zërin e kryebashkiakut Rama



Ngjyrat e Rilindjes? Bashkova të PS me të PD

"Do të përpqemi të përshtasim ato ndërtime pa leje që mund të legalizohen. Të tjerat, duhet të prishen. Shqipëria është vendi i dytë në Evropë me pasuri ujore. Por ende vuan për ujë"

LAJMI

Corriere della Sera e ka "vizatuar" ndryshe kryeministrin e ri të Shqipërisë. Artisti që do të bëjë politikanin. Që do të ndryshojë Shqipërinë me shpirtin e të bukurës. Në një intervistë telefonike, kryetari i PS që fitoi zgjedhjet, ka besim të rinia shqiptare dhe forca e saj; ashtu sikurse shprehet dhe për ndërtimet pa leje por edhe për "keqkuptimin" që u krijua me konceptin për "vdekjen", në një intervistë të tij të mëparshme. E pse zgjodhi ngjyrën e Rilindjes? Sepse bashkoi të kuqen me blunë. Ja si rrëfëhet në këtë portret kryeministri i ngjyrave



PAOLO CONTI

"Identiteti im si artist është pjesë e imja. Më ka shoqëruar si ministër i Kulturës, më pas si kryetar i Bashkisë së Tiranës, e do të më shoqërojë edhe si kryeministër. Tani është e nevojshme të fillojmë menjëherë një punë të rëndësishme në planin e të bukurës që është edhe resursi maksimal i Shqipërisë sonë".

Është një piktor në krye të një vendi, që flet në telefon nga Tirana. Një intelektual ka zbrakuar në dhomën e kontrollit. Një kryeministër që, si program qeverisës,

individualizon restaurimin e të bukurës, si një objekt politik-strategjik.

Edi Rama, i lindur në Tiranë në 4 korrik 1964, sjell fantazinë në pushtet në vendin e Shqipërisë dhe të Skënderbeut. Duke drejtuar një koalicion të qendrës së majtë, arriti t'i marrë disa ditë më parë qeverinë Sali Berishës, i datëlindjes 1944, një ish-mjek i shumë drejtuesve komunistë të kohës së Enver Hoxhës, kryeministër që nga viti 2005 dhe më parë president i Republikës nga 1992 deri në 1997, më të madhin e Partisë Demokratike. Një zëvendësim, jo vetëm gjeneratash, por mbi të gjitha dhe më thellësisht, intelektuale.

Edi Rama është një artist militant. Babai i tij, Kristaqi, ishte skulptor. Dhe ai i ka ndjekur gjurmët, duke studiuar në Akademinë e Arteve të Bukura, ku më pas edhe ka dhënë mësim. Është një eseist: me mikun e tij të vjetër Ardian Klosi, në vitin 1992 shkruajti "Refleksionet" një panflet politik e kulturor plot me sugjerime mbi të ardhmen e vendit. "Refleksionet" ishin një pikë referimi për një gjeneratë. Në mes të viteve '90, emigroi në Paris dhe atje zhvilloi së bashku me mikun e tij, Anri Sala, personalitetin e tij si piktor. Hapi ekspozita në Nju Jork, Paris, Berlin, San Paolo dhe Brazil. Në 1998 i erdh emërimi si Ministër i Kulturës. Por pika e kthesës, kryqëzimi në të cilin dy identitetet, i politikanit dhe artistit u takuan në të njëjtën rrugë, ndodhi në vitin 2000, në të parën, nga tre fushatat pozitive për kryetar bashkie në Tiranë. E fshiu ngjyrën "gri" të komunizmit nga fasadat e pallateve të Tiranës duke i zëvendësuar me një plan ëndërrues ngjyrash: një ballkon me



Pamje nga rrëfimi i Edi Ramës në videon "Dammi i colori"

ngjyrë të kuqe, ai afër tij me ngjyrë blu, fasadën me ngjyrë portokalli, kornizat ngjyrë të kaltër (blu) apo jeshile. Pa një dizajn të programuar, duke i lënë hapësirë improvizimit.

Një projekt i aplikuar në gjithë qytetin dhe që vendosi në plan të dytë vizualisht çarjet e rrugëve dhe pluhurin që mbulonte Tiranën. Sërish një përzierje e dy identiteteve: Anri Sala kthehet në 2003 në eksperimentin me ngjyra dhe urbanistik që u diskutua në Shqipëri, një film i shkurtër prej 15 minutash "Dammi i colori" (piktori Cavaradossi në operën Tosca, akti D) me komentet e Edi Ramës duke ecur me makinë gjatë natës nëpër rrugë e sheshes. Një veper fituese dhe e vlerësuar, e ekspozuar në Bienalen e Arteve të Venecias në 2003, ajo e Francesco Bonami, dhe më pas që u pranua përgjithmonë

në Tate Modern të Londrës. Një udhëtim në errësirën e Tiranës në zbulimin e këtij instalimi urbanistik të madh të ideuar dhe firmuar nga Rama, në mes të Piet Mondrian dhe Alighiero Boetti. Dhe zëri i kryebashkiakut që pëshpërit: "Qyteti kishte vdekur, dukej si një stacion tranziti, një vend ku qëndrohet vetëm për të pritur e për të ikur...duhet të gjenim mënyrën për të ndryshuar Tiranën nga një qytet ku të ka rastisur të lindësh, sepse kështu e desh fati, në një qytet në të cilin vendos të jetosh". Dhe më pas: "Nuk ka një qytet tjetër evropian në të cilin qytetarët diskutojnë kaq shumë për ngjyrat në rrugë, në bar, në shtëpi".

Sot Francesco Bonami thotë duke kujtuar atë Bienale: "Edi Rama bëri me artin një strategji politike dhe nga politika bëri art. Për ne italia-

nët, është një personazh shumë i çuditshëm, le të themi i paparashikueshëm. Nga një kaos siç ishte ai në Shqipëri, mund të lindin personazhe kreativë, si ai. Është një bast i madh".

Sot, si kryeministër, Edi Rama rrifillon nga ngjyrat. Për fushatën e tij elektorale përdori një violet vjollcë për sfondin e banerave elektorale, ngjyrë e projektuar për rrugët gjatë natës nëpërmjet flamujve që tundeshin dhe shiritave që kishin nëpër të.

Pse zgjodhët këtë ngjyrë zoti kryeministër?

"Sepse forcat tona politike kanë qenë gjithmonë të prezantuara nga bluja dhe e kuqja, të kundërtat e njëra tjetrës. Mendova se ajo ngjyrë mund të ketë një kuptim preciz: lidhja themelore e të dy ngjyrave krijon të tretën, pra pajtimin kombëtar. Unë jam një artist viziv, punoj shumë me ngjyrat: kemi parë shumë të bardhë e gri gjatë këtyre viteve".

Polemika e Edi Ramës sa i përket sistemit të pushtetit të Sali Berishës është politik e estetik: "Detyra e kryeministrit do të jetë më komplekse sesa me Tiranën. Them për punën që duhet të bëhet në planin e të bukurës: ai që ka drejtuar Shqipërinë gjatë këtyre viteve e ka dëmtuar territorin, panoramat. Ndryshimi ishte i paimagjinueshëm dhe brutal".

Duket sikur flet për Italinë, për masakrën e peizazhit tonë të mrekullueshëm, por në fakt jemi në Shqipëri: "Lëvizjet demokratike në vendin tonë kanë qenë të mëdha. Shumë njerëz kanë lënë fshatrat rurale më më varfër dhe janë përqëndruar në kryeqytet dhe në qytetet e tjera të mëdha. Kjo solli ngritjen e ndërtesave informale, të privuara nga çdo lloj lidhje me arkitekturën tradicionale, dhe projek-



SHPJEGIMI PËR CAVARADOSSIN

Në Romën e korruptuar të fillim shekullit të 19, dy të dashur, Floria Tosca dhe piktori Mario Cavaradossi, u ndanë nga lakmia e një burri djall të quajtur Scarpia. Ai nuk është thjesht një burrë, por edhe shefi i policisë duke mishëruar autoritetin në dramë. Në mënyrë që të marrë se çfarë kërkon nga Floria, Scarpia e çon në burg Cavaradossin dhe i jep dënimin me vdekje. Përpara ekzekutimit, Cavaradossi këndon një nga ariet më të bukura dhe më popullore të repertorit lirik, i cili përfundon me këtë piskamë shumë të bukur dëshpërimi: "Dhe kurrë më parë nuk e kam dashurur kështu jetën..." (anglisht. And I had never loved life more before...")



NË FOTO: Kreu i PS-së Edi Rama dhe mbarrat tji një prej pallateve të lyera ngjyra ngjyra në kohën kur ishte kryetari i bashkisë së Tiranës

timin më të keq të mundshëm. Ndërtesa është një nga levat më të rëndësishme për zhvillimin tonë, por kemi paguar shumë me rritjen e efekteve shkatërruese në mjedis".

E çfarë mendoni të bëni?
"Do të na duhet të vendosim se ç'do bëjmë. Në disa raste do të gjejmë mënyrën për t'i legalizuar, për t'i sjellë brenda rregullave. Në të tjera raste duhet të prishen. Nuk mund të vazhdohet kështu. Duhet të rikuperojmë kontrollin mbi territorin. Është thelbësore të rigjejmë për shqiptarët sensin e shtetit dhe institucioneve".

Dhe ja ku kthehemi në pikën ku u nisëm: restaurimi i bukurisë si një objektivi politik. Për Edi Ramën nuk do të jetë një debutim: si kryetar i bashkisë së Tiranës dhe urdhër për shembjen e më shumë se 500 ndërtesave të paligjshme në të gjithë kryeqytetin. I kthehu jetën zonave të gjelbra dhe parqeve, të zaptuara nga ndërtesa që ngjanin me anije kozmike të filmave për fëmijë (kioskat-bar që në fillim ishin simbol i lirisë nga diktatura komuniste, për rigjetjen e jetës sociale, por më pas u bënë ata diktatorët e jetës së Tiranës). Gjithmonë si kryebashkiak, mbolli rreth 500 mijë e më shumë pemë, dhe ndërhyri në rrugë dhe ndriçimin publik.

Nëse mund të tregoni objektivin e parë të qeverisë?

"Ka pasur vitet e kaluara një rënie të frikshme të cilësisë së bashkëjetesës civile. Shumë korrupsion. Që s'oli me vete kriminalitetin dhe papunësinë. Pra, varfëri". I njëjti korrupsion që solli edhe rrënimin urbanistik. Por Edi Rama është optimist: "Vendi ynë është i pasur me energji të pabesueshme. Përshehëmbull me të rinjtë, pavarësisht valëve

të mëdha të emigrimit sidomos në Greqi e Itali. Dhe të rinjtë janë të rëndësishëm për të ndryshuar vizionin e gjërave. Për shumë vite, nga ky këndvështrim, vendi jetoj në një kohë të lidhur me atë që realiteti në botë. Politika në fakt, ka arritur në një kohë tjetër më të largët, dhe që nuk kishte fare të bënte me këtë vend. Dhe pastaj, duhet të përballemi me një mal me probleme. Më vjen një i parë në mendje: Shqipëria është vendi i dytë më i pasur për burime ujore në Evropë. Por, 40% e tokave që janë të destinuara për kultivimin bujqësor, pra fertile, vuajnë thatësi, dhe nuk kanë një sistem ujëjete. Një problem tjetër? Nuk ka në të gjithë Shqipërinë një lagje të vetme që të ketë drita 24 orë në 24".

Lista e problemeve është e gjatë. A do të mjaftojë një jetë e artistit dhe politikantit? Kush e di.

Në një intervistë për "Courrier des Balkans" pak kohë përpara fitores, ju keni treguar se keni një problem me vdekjen dhe historinë. Në ç'sens?

Edi Rama qesh: "E thashë në një moment konfidencial. Janë dy motive të mundshme për të hyrë në politikë. E para, është të kërkojë të pasurohesh. E dyta është nevoja për të lënë një gjurmë. Ja, unë kam vërtet nevojë për të lënë një gjurmë, dhe në këtë gjë, mbetem një artist. Sa i përket vdekjes...sic thoshte Indro Montanelli, nuk është vdekja por është "të vdesësh" ajo që më tremb. Eja dhe më tako në Tiranë, nuk e di se kur do të kem kohë për të takuar, ndoshta edhe në mesnatë, por do ta gjej, natën e mirë".

Një artist po përgatitet për pallatin e pushtetit në Tiranë. Ka ndryshuar ngjyrat e kryeqytetit dhe tani puntan mbi të bukurin për të qeverisur. Me paletat e Cavaradossit.

"DO VAZHDOJMË TË RRITEMI"

Ilir Meta: LSI, shumë përfaqësim në qeveri

"Do t'ua shpërblejmë me punë dhe do mbajmë premtimet e bëra"

TIRANE
ARTEMISA HOXHA

LSI pas fitores me 17 deputetë në zgjedhjet e 23 qershorit, kërkon të shtojë radhët e anëtarësisë së saj duke u rritur akoma më shumë. Ndër të tjera, do të ketë përfaqësimin e saj në qeverisje, në nivelin më të madh e më të gjerë që ka pasur ndonjëherë. Synimi u bë i qartë nga kreu i LSI, Ilir Meta, gjatë takimit të mbajtur në Çorovodë, ku LSI u përaktua edhe si forcë e parë politike.

"Do kemi përfaqësimin më të madh kudo në të gjithë qeverisjen e vendit dhe të gjithë institucionet, që do të thotë se më shumë njerëz do të angazhohen dhe kjo është një përgjegjësi që do ta ndahet mes të gjithëve", tha kreu i LSI.

"Është vetëm fillimi i rritjes sonë do të vazhdojmë të rritemi akoma më tej, sepse në gjithçka e bazojmë te puna e përditshme, e vazhdueshme dhe tek përmirësimi i vetvetes. Pra, motoja jonë për të ardhmen është të punojmë çdo ditë dhe të përmirësohemi çdo ditë në mënyrë që të jemi më të aftë dhe më të suksesshëm në përbalimin e gjithë sfidave që kemi përpara" tha Meta.

Pas 9 viteve të krijimit të kësaj force politike, Ilir Meta, u kërkoj dy deputetëve të zgjedhur në qarkun e Beratit, që t'u qëndrojnë sa më afër njerëzve. Për rezultatet e vitit 2009 ai tha se LSI u ndesh jo thjesht me partitë e mëdha, por me "një sistem shtypës dhe shkatërrues të zgjedhjeve të lira e të ndershme".

Rritja e elektoratit të LSI sipas Metës, është rezultat i punës këmbëngulëse të të gjithë strukturave. "Bëmë një fushatë pozitive, konkrete, me premtime të përbajtura. Votuesit tanë kërkojnë stabilitet, kërkojnë rritjen e punësimit, dhe ne duhet të mbajmë këto premtime" vazhdoi kreu i LSI.

"Ne pas zgjedhjeve nuk i ndajmë skraparllinjte as këtu as kudo tjetër, përkundrazi përpigëmi t'i respektojmë dhe t'i mbështesim të gjithë. Fitorja në Qarkun e Beratit është historike sepse është hera e parë që LSI-ja del forcë e parë politike në një qark të Shqipërisë dhe kjo është mjaft kuptimplotë, por natyrisht ne do të vazhdojmë me synimet tona për të fuqizuar më tej LSI-në",



Ilir Meta

thi Ilir Meta.

"Qytetarët shqiptarë e duan fuqizimin e LSI-së dhe kontribuuan me votën e tyre për këtë qëllim, sepse duke u fuqizuar LSI-në si

forcë politike forcohet stabiliteti i vendit, ndihmohet çdo qytetar shqiptar që të shikojë një politikë e cila merret me ekonominë dhe nuk merret retorika boshë.

Kryeministri

Berisha: Dorëheqja, betimi im që në vitet '91

Kryeministri në largim, Sali Berisha edhe pse prej disa ditësh ka nisur t'u përgjigjet një më një pyetjeje në Facebook, këtë herë ka preferuar t'u drejtojë të gjithëve një përgjigje mbi dorëheqjen nga drejtimi i PD-së. Berisha shkruan se, dorëheqja pas humbjes në zgjedhjet e 23 qershorit nuk ishte emocionale dhe as e nxituar, por e detyruar. Kryeministri thekson nga ana tjetër se, vendimin që shpalli më 26 qershor e ka marrë si një betim në verën e vitit '91. "Unë dhashë dorëheqjen jo nga emociione, as dhe nxitim, por sepse nuk mund të merrja vendim tjetër. Sikundër dua t'ju rrëfej sot haptazi se vendimi që shpalla më datë 26 qershor është marrë si një betim nga unë në verën e vitit 91 dhe nga ajo kohë nuk e kam vënë kurrë në diskutim. Kur prin, kur udhëheq, duhet të ndërtohet jo vetëm sulmin e fitores, por duhet të parashikosh gjithnjë dhe tërheqjen në rastin e humbjes, si kushtin vendimtar që kjo e fundit të shndërrohet në sfidë për fitoren



Sali Berisha

e radhës", shkruan Berisha. Më tej, në komentin e gjatë të tij, kryeministri bën të ditur se do të qëndrojë në Parlament duke bërë një opozitë të fuqishme. "Ne do të qëndrojmë avoketë të pamposhtur të parimeve dhe vlerave që besojmë dhe të mbarë qytetarëve shqiptarë, të atyre që na votuan ne dhe të atyre që besuan premtimet anti-globaliste të kundërshtarëve tanë, të cilët sapo morën votën nisën t'i zëvendësojnë premtimet e tyre me revanshin e papërbajtur të pushtetit që lindi siç po duket çdo ditë e më shumë nga mashtrimi", thotë ai.



Korçë, aksidenti humb jetën 30-vjeçari

Një 30-vjeçar ka humbur jetën si pasojë e një aksidenti rrugor në Korçë. I riu, Kristi Bica, ishte duke udhëtuar me motor në unazën e qytetit, në çastin kur është goditur për vdekje nga një automjet tip "Fiat", me targa AA2230CD. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 13.00 të ditës së djeshme, ku si pasojë e përplasjes, 30-vjeçari ka gjetur vdekjen e menjëhershme. Policia shoqëruar në komisarariat drejtuesin e automjetit, Leonard Memelli, 20 vjeç, nga Maliqi. Uniformat blu, po punojnë për zbardhjen e ngjarjes.



Mbyten 2 të rinj, në Mat e në Gjirin e Lalzit

Dy të rinj janë mbytur ditën e djeshme, njëri në lumin e Matit, e tjetri në Gjirin e Lalzit. Nga hetimet paraprake, mësohet se 20-vjeçari i mbytur në lumin Mat, në zonën e Klosit, kishte shkuar në lumë për t'u larë me shokët. Po kështu, edhe 22-vjeçari tjetër i mbytur Besim Maja, nga Borizana e Krujës, kishte shkuar në plazh në Gjirin e Lalzit me shokët. Mendohet se 22-vjeçari nuk dihte not. Polumbarët kanë nxjerrë trupin e 20-vjeçarit të mbytur në lumin Mat, ndërsa po vijojnë kërkimet për 22-vjeçarin.

KRIMI MAKABËR/ Vdes Valbona Çarçani 46-vjeç, e vret ish burri

Bashkëshorti, tri thika në zemër nënës së dy vajzave

Sherri në lokal për vajzat. Qytetarët bënë "sehir"

LAJMI

Një ngjarje e rëndë ka tronditur banorët e rrugës "Tefta Tashko" në Tiranë mëngjesin e djeshëm. Nga krimi makabër mbeti e vdekur Valbona Çarçani 46-vjeçe e goditur me thikë tre herë drejt e në zemër nga ish-bashkëshorti i saj Genci Çarçani 48-vjeç. Sipas policisë krimi ka ndodhur për shkak të xhelozisë, por sipas dëshmitarëve okularë në vendngjarje, dy ish bashkëshortët, po debatonin për vajzat.

TIRANE

JONIDA ALIU

Orë 9.45 e ditës së djeshme. Qytetarët që ecnin në rrugën "Tefta Tashko" në Tiranë, ndaluan hapin dhe po shihnin skenën makabre ku një grua e shtrirë për tokë bërtiste: "ndihmë, ndihmë", "aiuto, aiuto", ndërsa një burrë, ish bashkëshorti i saj, e guante me gjakftohësi me thikë në zemër. Krimi makabër, po ndodhte në sytë e dhjetëra qytetarëve dhe askush nuk pati guxim të afrohej.

Genci Çarçani, 48 vjeç, me arsim të lartë, i ishin errur sytë. E qëlloi me thikë ish bashkëshortin e tij Valbona Çarçani, 46 vjeç, por nuk u mjaftua me aq. Për të nxjerrë milletin dhe urrejtjen, pa u menduar dy herë, ngriti dorën duke goditur me thikë tre herë, drejt e në zemër, nënën e dy vajzave të tij, 18 dhe 20 vjeçare. Çifti kishte kohë që ishte divorcuar pas një martesë 24 vjeçare, dhe ajo e ditës së djeshme, do të ishte edhe biseda e fundit mes tyre.

SHERRI

Çifti prej vitesh kishte jetuar më parë në Udine të Italisë. Kohët e fundit, ishin kthyer në Tiranë, siç thonë edhe burimet policore. Shtëpinë e tyre e kishin në lagjen "Mine Peza", por për të shmangur debatet me ish-bashkëshortin gruaja bashkë me vajzat ka shkuar të jetojë në shtëpi me qera. Ditën e djeshme, debati nisi fillimisht në një lokal të lagjes. Dëshmitarët

që i kanë parë duke debatuar shumë, kanë evidentuar faktin se Genci Çarçani ka pasur një thikë në brez. Pas më shumë se 30 minutash debat, gruaja, që pak më vonë do të humbte jetën në mënyrë makabre, doli nga lokali duke mbajtur një qen në dorë. Ish-bashkëshorti i saj e ndoqi nga pas dhe momenti kur Valbona do të kalonte rrugën, ishte fatal për të. Bashkëshorti iu afrua sërisht dhe po prapë nisi të debatojë. Fillimisht ai e ka lënë të plagosur gruan duke e goditur në shpinë. Në këtë kohë



Valbona, që ndjen rrezikun, filloi të bërtasë me të madhe duke kërkuar ndihmën e banorëve: "ndihmë, ndihmë" dhe më pas "aiuto, aiuto". Banorët e lagjes janë afruar aty pranë, por askush nuk i

ka shkuar në ndihmë gruas, përveçse qeni që ka filluar të lehtë dhe i është hedhur përsipër, duke dashur ta ndalojë, ish-bashkëshortin e viktimës. Por nuk ka mundur ta ndalojë. Kur 46-vjeçarja ka rënë

në tokë nga goditja e parë e thikës, ish-bashkëshorti i saj i ka ngulur thikën edhe tre herë të tjera drejt e në zemër, duke e lënë atë menjëherë të vdekur. Dëshmitarët që e kanë parë të gjithë skenën e



QENI

Banorët e lagjes janë afruar aty pranë, por askush nuk i ka shkuar në ndihmë gruas, përveçse qeni që ka filluar të lehtë dhe i është hedhur përsipër, duke dashur ta ndalojë, ish-bashkëshortin e viktimës.

NË FOTO:
Trupi i pajetë i Valbona Çarçani

Pistat

Policia: Ish-bashkëshorti e vrau për motive xhelozie, i sekuestruam thikën

TIRANE

Sot, rreth orës 09:45, në Rrugën "Tefta Tashko" Tiranë është vrarë me thikë, shtetasja Valbona Tasim Çarçani, vjeç 46, me arsim të lartë, banuese në Tiranë, gjendja familjare e divorcuar.

Menjëherë në ndjekje të autorit janë vënë Shërbimet e Autopatrolles Speciale "Shqiponja" të cilat kanë bërë të mundur 300 metra larg vendit të ngjarjes e konkretisht në sheshin "Avni Rustemi" në Tiranë kapjen e autorit, i cili është ish-bashkëshorti i viktimës shtetas: Genci Selfo Çarçani, 48 vjeç, me arsim të lartë, lindur dhe banues në Tiranë, gjendja familjare e divorcuar. Në momentin e kapjes autorit ju gjend me vete dhe sekuestrua arma e krimet e cila është një thikë e përmasave të mëdha me mb-



ishkrimin "Columbia". Po kështu në vendngjarje shkuan menjëherë shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr.1 dhe Oficerët të Sektorit Kundër Krimeve të Rënda në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë, u formua grupi i posaçëm hetimor i cili kreu veprimet e

para hetimore dhe proceduriale, duke kqyrr vendin e ngjarjes, administruar provat, shoqëruar dhe pyetur persona te tjere që kanë dijeni për këtë ngjarje. Nga hetimet paraprake rezultoi se martesë e ketyre shtetasve ka zgjatur rreth 24-vjet dhe para dy vjetësh janë divorcuar. Viktima dhe autori janë prindërit e dy vajzave përkatësisht 20 dhe 18 vjeç. Autori dyshohet ta ketë kryer krimin për motive xhelozie. Në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë po punohet intensivisht në drejtim të dokumentimit të plote ligjor të kësaj ngjarje. Materialet do t'i kalojnë Prokurorisë, për veprime të mëtejshme, për veprën penale të "Vrasjes për shkak të marrdhënieve familjare" dhe "Mbajtjes pa leje të armëve të ftohta në mjedis publik" parashikuar përkatësisht nga neni 79/c dhe 279/2 të Kodit Penal.

krimit thonë se pas vrasjes, autori Genci Çarçani, është larguar i qetë nga vendi i ngjarjes dhe duke mos u mjaftuar me kaq ka marrë me vete edhe qenin e gruas dhe çantën e saj. Madje siç rrefejnë fqinjët, inati me ish-bashkëshortin nuk i ka dalë edhe pasi e ka lënë pajetë, dhe ka tentuar ti presë edhe dorën ku mbante të lidhur litarin e qenit, por më pas ka prerë vetëm litarin. Autori është larguar sërisht i qetë, në këmbë nga vendi i ngjarjes, por është arrestuar nga blutë e policisë vetëm 300 metra larg vendit të ngjarjes e konkretisht në sheshin "Avni Rustemi" në Tiranë. Ndërsa trupi i viktimës ka qëndruar për rreth një orë në rrugë për shkak të vonës së ekspertëve të mjekësisë ligjore. "Autori dyshohet ta ketë kryer krimin për motive xhelozie" - thotë policia. Por sipas banorëve të lagjes konflikti mes çiftit ka nisur për shkak të vajzave. Ata kanë dëgjuar ish-bashkëshortin e gruas që kishte duke i ai i shkontë në shtëpi, duke i kërkuar asaj që të takojë vajzat, por tre nuk i ka gjetur në shtëpi vajzat. Më pas debatohte me gruan, duke i thënë se ku i kishte qar vajzat dhe pse ato nuk ishin në shtëpi në orët e vona të natës.



Ura Vajgurore, grabiten 20 mln lekë

20 milionë lekë të reja janë grabitur dje në banesën e një biznesmeni Edmond Piti në Urën Vajgurore. Katër persona të maskuar kanë hyrë në banesën e tij dhe ia kanë marrë lekët me dhunë. Pasi u njoftua për këtë grabitje, grupi hetimor shkoi menjëherë në vendngjarje dhe nisi veprimet e para procedurale. Policia e Beratit ka arrestuar 4 grabitësit e maskuar. Personi që u grabit ishte pronar i një karburanti dhe paratë i mbante në banesë për arsye biznesi.



Përplasat furgoni vdes 1 grua, plagosen 5

Një furgon pasagjerësh që shkante në Rogozhinë është përplasur pasditen e djeshme në Kavajë me një autoveturë. Si rrjedhim ka vdekur një grua, Dove Xhaferaj-58 vjeçe nga Vlora dhe janë plagosur pesë të tjerë, ndërmytet tyre edhe bashkëshorti i saj, Lavdosh Xhaferaj. I plagosuri i dytë quhet Skënder Rapi - 26 vjeç dhe tri të tjerët ende nuk janë bërë të ditur. Policia ndodhet në vendngjarje për të zbuluar shkaqet e aksidentit, por ato ende nuk janë zbardhur.



CEREMONIA MORTORE

Në shtëpinë e familjes Çarçani, në rrugën "Tefta Tashko", ku jetonte me qera viktima Valbona Çarçani bashkë me dy vajzat e saj, dyert janë të mbyllura. Ceremonia mortore e 46-vjeçares nuk do të bëhet në shtëpinë e tyre, por tek të afërmit e saj.

Gjykata

Divorci paqësor i çiftit Çarçani, plot 23 vjet pas martesës me dashuri

Çifti Genci dhe Valbona Çarçani është ndarë me vendim gjykate në datën 2 maj 2011, thuhajse 23 vjet plot pas lidhjes së martesës së tyre më 6 maj 1988. Valbona ishte me arsim të lartë dhe zotëronte një aktivitet privat, kurse Genci, po ashtu me arsim të lartë, ishte i papunë. Ata kishin dy fëmijë, dy vajza. Në gjykatë është kërkuar me mirëkuptimin e të dyve, lënia e fëmijëve për rritje e dukim, Valbonës. "Nisur nga komunikimi i ngrohtë dhe i afërt me nënën, si ai verbal dhe ai joverbal, afrimiteti mes tyre, marrëdhënia e tyre më e ngrohtë, mirëkuptimi midis çiftit Çarçani, që fëmijët t'i lihen nënën për rritje dhe edukim, si dhe nevojat aktuale plotësohen më së miri prej nënës...", thuhet në vendim. Kurse bashkëshorti do të paguante 50 mijë lekë për rritjen e tyre dhe kishte të garantuar edhe të drejtën e takimit sipas vendimit të gjykatës. Në përshtatje me faktin që figura e babait është e rëndësishme në mirërritjen e fëmijëve, faktin që



Faksimile e vendimit

i padituri mund të kontribuojë në përkujdesjen e tyre, Gjykata çmon që ai të takoj dhe të mbaj në banesë fëmijët të shtunën e parë, të tretë dhe të katërt të çdo muaji nga ora 17:00 të deri në orën 13,00 të ditës pasardhëse si dhe për pushime vjetore nga data 16-31 gusht të çdo viti kalendarak". Arsyet e divorcit të kërkuara nga Valbona kanë qënë kontradiktat e shumta, të lindura nga vështirësitë ekonomike, vështirësitë në komunikim, grindjet e vazhdueshme që e kanë bërë të pamundur, vazhdimin e bashkëjetesës. Nga vendimi, bie në sy fakti që paditësja nuk ka kërkuar nga gjykata të gjendet fajtori për prishjen e martesës; gjithashtu, ajo ka kërkuar të mbajë mbiemrin e saj të pasmartesës dhe i ka lejuar bashkëshortit të takohet lirish me vajzat. Gjykata ka vendosur që takimi i babait me vajzat e tij të bëhet 3 të shkuna të muajt si dhe për pushime vjetore, ndërsa pagesën mujore për fëmijën e ka ulur në 10 oolekë në muaj.

"U largua i qetë sikur asgjë të mos kishte ndodhur"

TIRANE

JONIDA ALIU

Banorët e rrugës "Tefta Tashko" të cilët kanë parë ngjarjen tragjike ku ish-bashkëshorti vrau nënën e dy fëmijëve të tij rrefejshëm se çfarë ndodhi mëngjesin e djeshëm. Dëshmitarët okularë të krimit makabër thonë se janë tmeruar nga kjo ngjarje e rëndë. Ata tregojnë se kanë dëgjuar ulërimat e gruas dhe se në fillim kanë menduar se ka qenë një grabitje pasi 48-vjeçari Genci Çarçani ka marrë çantën e gruas dhe qenin që ajo mbante në duar. Shitësja e një dyqani thotë se ka parë tmerr me sy. Ajo tregon se në fillim ish-bashkëshorti i gruas e ka qëlluar në shpinë. Ndërsa në momentin që gruaja ka rënë në tokë, 48-vjeçari Genci Çarçani i ka ngulur thikën tre herë drejt e në zemër. "Ishte duke ndenjtur brenda, por më pas dëgjova ulërimat që sa vinin dhe shtoheshin, në fillim ishin të lehta dhe më pas po bëheshin më të forta dhe shqetësuese. Dola jashtë dhe pashë që zonja qëndronte në mes të rrugës. Ishte e gjakosur dhe fillimisht mendova se po e ngacmonte qeni.

Banorët: Nuk iu afruam, kishim frikë

Dëshmitarët: E qëllloi me thikë mbas kurrrizit

Pashë pastaj një burrë që po i vinte rrotull dhe thashë se po e shpëtonte, por ai ishte edhe personi që e qëllonte me thikë. E qëllloi me thikë mbas kurrrizit dhe në atë moment ajo po rrotullohej në këmbë dhe më pas u rrezua në tokë. Ai, pasi zonja ra në tokë e qëlloi përsëri edhe tre herë drejt zemrës. Më pas ajo u përpëllit në tokë tre herë, duke lëshuar dhe duart. Aty ka humbur jetën menjëherë. Pastaj zotëria i mori qenin, duke ja hequr nga dora. I mori edhe çantën që ajo mbante në krahe. Më pas iku i qetë fare, as nuk vraponte asgjë. Banorët kishin plot rreth e rrotull dhe të gjithë i flasin që të mos e bënte sepse



është gjynah, është femër, çfarë je duke bërë, por askush nuk u afrua sepse kishin frikë sepse

ishte me thikë në dorë", - na thotë shitësja e dyqanit. Të njëjtën gjë tregon edhe një

pas "aiuto, aiuto". Ndërsa fqinja e cila ka banesën ngjitur me të viktimës tregon se një herë në darkë ajo kishte dëgjuar ish-bashkëshortin e viktimës që bërtiste me të madhe dhe bënte debat me 46-vjeçaren për vajzat. "Valbona gjithmonë më është dukur sikur kishte probleme mendore sepse ishte komplet e çekulibruar si njeri. Këtë e them se është zënë shumë herë pa arsye me banorë të lagjes dhe fillonte të ofendonte pa lidhje në gjuhën italiane" thotë ajo. Ajo gjithashtu tregon se familja Çarçani kishte vështirësi edhe nga gjendja ekonomike. "Ishte të varfër. Bënte debate të shpeshta me pronaren e shtëpisë, për shkak se nuk kishte para që ti paguante qeranë." Ndërsa djali i fqinjës përballë tha dje në mëngjes herët ish-bashkëshorti i viktimës ka kaluar dy herë përpara shtëpisë së tyre. Ndërsa Valbona doli nga shtëpia bashkë me vajzat që ti përcëllte për në plazh" tregon ai. Persona të tjerë të lokalit ku ka filluar edhe shërbimi kanë vënë re që 48-vjeçari ka pasur një thikë në brez, ndërkohë që debatonte me viktimën. Në lokal një vajzë e vogël i ka thënë babait të saj që "ai xhaxhi ka thikë mbraja".

FQINJA

"Valbona gjithmonë më është dukur sikur kishte probleme mendore sepse ishte komplet e çekulibruar si njeri. Këtë e them se është zënë shumë herë pa arsye me banorë të lagjes dhe fillonte të ofendonte pa lidhje, në gjuhën italiane".

NË FOTO:

Vendi ku ndodhi ngjarja

veteriner, i cili ishte dëshmitar i ngjarjes. Ai thotë se 48-vjeçari pasi kreu krimin e rëndë, u largua i qetë sikur asgjë të mos kishte ndodhur. Ndërsa një zonjë tjetër e pallatit përballë vendit ku ndodhi ngjarja thotë se gruaja kërkonte ndihmë të dukur thirrur "ndihmë" dhe më



Denoncojnë banorët: Pamë te gjurmimet ministren e Berishës

Gjurmimet shumë pranë murit të Kalasë së Prezës kanë rënë në sy dhe janë denoncuar nga banorët e komunitetit, të cilët kanë treguar se prej momentit të nisjes së punimeve "kanë vënë re praninë e një anëtari të kabinetit Berisha". Saktësisht banorët treguan se bëhet fjalë për një nga "ministrat e Berishës". Pas këtij

konfirmimi të banorëve mësuam se objekti që pritet të ndërtohet i përket familjes së ministres së Integritimit Majlinda Bregu, konkretisht vjehrrit të saj, që konsiston të jetë siç u shprehën banorët, "ministre e Berishës". Kamera e A1 Report ka shkuar në vendngjarje për të filmuar këto gjurmime dhe pamjet tregojnë se në rrëzë të Kalasë

së Prezës gjatë gjurmimeve kanë dalë në shesh gurë të mëdhenj, të cilët u përkasin ndërtimeve prehistorike dhe për më tepër këta gurë janë copëtuar dhe thërrmuar nga një ekskavator me matrapik. Dje u konstatua se gjurmimi me mjete të rënda është bërë në një zonë arkeologjike dhe pa praninë e ndonjë specialisti apo arkeologu.

Ekskavatorët gjermojnë murin për godinën e vjehrrit

Bregu ndërton në Kalanë e Prezës

Shkelje flagrante e nenit 32,33 dhe ligjit 9

LAJMI

Prej më shumë së dy javësh, fill pas zgjedhjeve, kanë nisur punimet me shpejtësi për ndërtimin e një objekti që i përket familjes së ministres Bregu ngjitur me murin rrethues të Kalasë së Prezës dhe në kundërshtim të plotë me ligjin

TIRANE

DHURATA HAMZAI



Kalaja e Prezës

Buldozerë me tonazh të rëndë dhe matrapik kanë gjurmuar thellë dhe kanë sjellë përpara grumbuj gurësh të mëdhenj në një distancë vetëm 4-5 metra larg

nga rrëza e Kalasë së Prezës. Kamerat e A1 kanë filmuar dje një hapësirë të zënë për ndërtimin e një objekti pranë kësaj

kalaje. Ndërkohë banorët e Prezës iu kanë treguar se bëhet fjalë për një objekt të një ministri të "kabinetit

LIGJI

Është shkelur në mënyrë flagrante neni 32 dhe 33 i Trashëgimisë Kulturore. Ligji numër 9/43 i datës 07.04.2003 për Trashëgiminë Kulturore ndalon në mënyrë eksplicite ndërtimin pranë mureve të Monumenteve të Kulturës.

Berisha". Pasi mësohet se bëhet fjalë për ministren e Integritimit Majlinda Bregu, ka reaguar dje zyra për shtyp e ministres Bregu, që konfirmoi se bëhet fjalë për një pronë të vjehrrit të saj, që e ka pasur që nga viti 1900. Më tej, zyra për shtyp e ministres ka komentuar se "janë zbatuar parametrat e urbanistikës".



NË FOTO:
Eskavatori duke gjurmuar rrëzë Kalasë së Prezës për ndërtimin e familjes Ajazi

Mësuam se për këtë ndërtim që bëhet pranë një Monumenti të rëndësishëm Kulturore është dhënë leje nga ish-ministri i Turizmit dhe Kulturës Aldo Bumçi. Ndërkohë dje gazetarja e A1 Report, Mira Kazhani, ka kontaktuar dje me njërin prej anëtarëve të Forimit për Mbrojtjen e Trashëgimisë, Artan Shkrelin, i cili shpjegoi se leja e dhënë nga ministri Bumçi apo edhe nga Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimit

"është dhënë në shkelje të hapur e ligjit". Gjithashtu, pasi ka parë vendin ku janë bërë gjurmimet, arkeologu Artan Shkreli ka konstatuar se janë shkelur "në mënyrë flagrante neni 32 dhe 33 i Trashëgimisë Kulturore". Punimet rrëzë murit të Kalasë së Prezës kanë jo më shumë se dy javë që kanë nisur dhe, siç pohojnë banorët, janë shoqëruar edhe nga vizita e ministres Bregu dhe familjarëve të saj vetëm pak ditë pas zgjedhjeve.

Intervista

Artan Shkreli: Leja e ministrit Bumçi shkelje e rëndë

Ministri i Kulturës, Instituti i Monumenteve dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimit kanë vepruar si një bandë

Specialisti Artan Shkreli ka shpjeguar pse ngritja e një godine rrëzë Kalasë nuk është e lejueshme dhe se "ministria Bregu ka ushtruar influencën e saj te kolegu i saj Bumçi për të marrë leje për godinën e vjehrrit". Shkreli thotë se përveç këtij rasti nuk është dhënë kurrë leje për ndërtim në këtë Kala.

Zoti Shkreli, tashmë është bërë publike çështja e një ndërtese pranë klasës së Prezës. Bëhet fjalë fakt për vjehrrin e ministres së Integritimit Majlinda Bregu. Kemi komunikuar me zyrën për shtyp të ministres Bregu dhe sqarohet që "gjithçka është bërë konform ligjit të urbanistikës"...?

-Në distancën ku po gërmohet nuk është e lejueshme. Janë shkelur disa norma të trashëgimisë kulturore. Në gjithë këto vite nuk është dhënë asnjë leje ndërtimi, ku ndërtesat ekzistuese janë bërë pa leje, ndërsa çuditërisht kjo jepet me leje. Kjo është skandalozë.

Dhe jo rastësisht kjo godinë jepet me leje, se mesa duket ministrja ka ushtruar influencën e saj pranë kolegut të saj ministër që të marrë leje për një vend ku nuk jepet leje. Kjo është më e rëndë se ndërtimet pa leje. Për ndërtimet pa leje në një moment ndërgjegjësimit të shtetit mund të mirren masa kundrejt personave që kanë ndërtuar në mënyrë të paligjshme. Ndërsa objekti ku është abuzuar me pushtetin dhe është dhënë me leje për shkak të konfliktit të interesit ku kolegu ministër jep leje për vjehrrin apo për të shoqin që është e njëjta gjë, atëherë kemi me një shkelje të dyfishtë të ligjit, ku kemi hapur edhe se ka konflikt interesi.

Thuhet që leja është dhënë nga ministri i kulturës Aldo Bumçi?

-Leja natyrisht që është dhe miratuar nga Instituti i Monumenteve të Kulturës që ka përgjegjësi të drejtëpërdrejtë nga Këshilli Kombëtar i Restaurimit, të cilët kanë vepruar të



Artan Shkreli

gjithë bashkë si një bandë dhe bien dakord të shkelin ligjet e trashëgimisë kulturore dhe është firmosur nga Ministri i Kulturës, tek e fundit e ka bërë të mundur që kryetari i komunës ta zbardhë këtë leje që natyrisht bie në kundërshtim me ligjin dhe të gjithë bashkë kanë bërë të mundur që të shkelin ligjet në fuqi.

Cilat nene bien ndesh...?

-Aty nuk bëhet fjalë fare për ndërtesë. Ajo është një cope toke, e cila bënë pjesë në peizazhin mjedisor dhe historik të kalasë së Prezës

Ka qenë pronë e familjes që në vitin 1900, thuhet?

-Pronë mund të ketë kudo, mund të ketë pronë edhe në sheshin Skënderbej. Kjo nuk do të thotë që duhet të bëhen ndërtime në zonat historike muzeale mjedisore në zonat e mbrojtura të shpallura monumente e kështu me radhë. Pra të qenit pronar nuk të jep asnjë atribut për të ndërtuar në zonat ku shteti ndalon në mënyrë të rreptë ndërtimin...

Ka dhe të tjera ndërtesa që janë pranë Kalasë së Prezës?

-Asnjë godinë nuk është aq pranë Kalasë së Prezës sa godina që po ndërtohet e cila është vetëm 5-6 metra larg dhe faktikisht hyhet me ekskavator... duke thërrmuar gurët mbi të cilët mbështetet kjo kala. Mund të shihet me sy se çfarë batërdie po ndodh në krahuin verior të kështjellës duke shkelur në mënyrë flagrante neni 32 dhe 33 të trashëgimisë kulturore. Ligji numër 9/43 i datës 07.04.2003 për Trashëgiminë Kulturore ndalon në mënyrë eksplicite ndërtimin pranë mureve të Monumenteve të Kulturës.



Kalaja e Prezës, një histori e shkurtër e monumentit

Kjo kala është ndërtuar mbi një shkëmb. Ana lindore e kalasë është e mbrojtur nga vetë terreni, kurse ana perëndimore përbën një territor të sheshtë. Kalaja ka planimetri katërkëndore me brinjë 80 x 50 m. Ajo përfërcohet nëpër qoshe me katër kulla që kanë planimetri rrethore. Përmasat e vogla të saj si dhe qëndrueshmëria jo shumë e madhe e

mureve rrethuese, e klasifikojnë këtë kala si një objekt që ka shërbyer për vëzhgimin e rrugëve të rëndësishme ekonomike dhe ushtarake, që kalonin poshtë saj, nëpër fushën e Tiranës. Ndihmesën e parë për sajën i përket datimit të saj nga jep Marin Barleti. Në pjesën ku bën fjalë për ardhjen e ushtrisë turke dhe rrethimin e Krujës, ai përmend fushën e Tiranës që e

vendos midis qytetit të Krujës dhe qytezës së parthinëve. Më poshtë ai thotë se kjo qytezë quhej me emrin Prezë dhe ishte kthyer në një gërmadhë. Sipas burimeve historike kjo kala është braktisur në kohën e Gjon Kastriotit, dhe më vonë nuk u rindërtua më. Pas pushtimit të Krujës nga osmanët, aty u bënë disa rindërtime, si dhe u ndërtuan një objekt kulturi.



TIRANE

GENC KONDI

Vjeçri dhe kunati i ministres 8-vjeçare të integritimit, Majlinda Bregu, përkatesisht Beqir dhe Hektor Ajazi, kanë shumë kohë që po terrorizojnë banorët e zonës së Prezës. Pretendimi i tyre është se këta banorë kanë marrë tokat e tyre. Në fakt, pronarët aktualë kanë marrë toka nga ligji 7501 dhe nuk përjashtohet mundësia që të jenë bërë pronarë të trojeve që dikur ishin të familjes Ajazi. Por, një problem i tillë ekziston në të gjithë vendin dhe Beqir e Hektor Ajazi nuk bëjnë përjashtim nga ish-pronarët e tjerë të tokave bujqësore. Shteti shqiptar ka marrë përsipër kompensimin financiar apo në natyrë të ish-pronarëve, tokat e të cilëve u janë shpërndarë banorëve të ish-kooperativave apo ish-fermave bujqësore dhe, sipas radhës, edhe ata do të marrin shpërblimin e caktuar.

Por, Ajazët kanë dashur dukshëm të bëjnë vetëgjyqësi, duke shkelur mbi ligjet ekzistuese. Në kushtet kur ligji nuk e lejon tjetërsimin e pronës së regjistruar tashmë, ata kanë përdorur edhe falsifikim në akte zyrtare noteriale, duke u hequr se toka u ishte dhuruar nga ana e pronarit të ri, por nuk ka mundur edhe dhuna fizike, për të terrorizuar banorët dhe paditësit e tyre në gjyqe të njëpasnjëshme.

Gjithshka lidhet me oreksin e madh që ka kjo familje për këto toka shumë pranë Tiranës, Durrësit dhe aeroportit, ku kalojnë artere të mëdha nacionale rrugore, në një ballkon natyror.


RGJYQI

Një vit më parë, një vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë i 20 qershorit 2012, ka marrë në shqyrtim padinë civile të ngritur nga familja e Ramiz Kapllanit. Ky i fundit kishte përfutur dy parcela prej ligjit nr.7501, dt.19.07.1991 "Për token". Me aktin e marrjes së tokës në pronësi nr.198, datë 8.10.1992, katër pjesëtarët e familjes kanë përfutur tokë bujqësore 10.000 m2, të ndarë në dy parcela me 4.000 m2 dhe 6.000 m2, për të cilat kanë titull pronësie të regjistruar. Kur kanë kontrolluar gjendjen e pronës, kanë konstatuar më pas se në pronësi të tyre nuk ekzistonte sipërfaqja prej 6000 m2, pasi figuronte e regjistruar në emër të vjehrrit të ministres Bregu, Beqir Ajazi,

Hektor Ajazi bëri dëshmitarin për spital më 2010

Ajazët, një lumë falsifikimi e kërcënimesh

Gjyqi, dokumentat për çështjen e Prezës



Faksimile e vendimit të gjykatës së Apelit që shpall të falsifikuar aktin e marrjes në pronësi të 6 mijë metrave katrorë trual nga Beqir Ajazi



Beqir Ajazi



Namik Ajazi



Hektor Ajazi

Kapllanit, dhënë për Shqiptarja.com me telefon, ai është kërcënuar vazhdimisht nga persona të njohur e të panjohur, që kanë ardhur kryesisht natën pranë shtëpisë së tij me makina fuoristradë e duke i kërkuar të shkojë tek noteri të nënshkruajë një akt dhurimi të pronës së përfolur. Kapllani e ka ndërjet vetën shumë të kërcënuar, duke qenë se të dy djemtë i ka në Itali dhe banon vetëm me gruan. Megjithatë, ai ka rezistuar dhe nuk ka pranuar të kryejë veprimin e kërkuar prej tyre.

Në një rast të mëparshëm vetë kunati i ministres, Hektori, ka marrë një dënim – tepër të lehtë – për një rrahje ndaj shtetasit Naim Sela, me dëmtime të shkaktuara trupore ndaj tij.

Ngjarja u denoncuar në vitin 2010 në polici dhe, sipas kronikës së saj, ngjarja kishte ndodhur rreth orës 19.00 në ambientet e firmës "Kajmak" në autostradën Tiranë-Vorë. Policia tha se shtetasit Naim Sela është goditur me grushta nga Besnik Zef Lala dhe Hektor Beqir Ajazi, të cilët i shoqëroi dhe më pas i la të lirë.

Sipas Naim Selës, i cili dëshminë e tij e dha nga Spitali Ushtarak, ai u godit nga Hektor Ajazi fillimisht dhe më pas nga truporiat e tij. Sela tha se gjithshka ka lidhje me një konflikt pronësie, çështje që po shqyrtohej nga gjykata, ku Sela ishte dëshmitar dhe palë kundërshtare e Hektor Ajazit. Sipas tij, e gjithë kjo u bë për ta detyruar të ndryshonte qendrim në sallën e gjyqit. "Hektor Ajazi ka marrë pronat. Ka mashtuar një fshatarin tim; unë dola për ta mbrojtur atë në gjyq", tha shprehimisht Sela.

Ajazi u dënua vetëm me gjobë, duke përdorur varjantin lehtësues të përdorimit të pijes alkoolike, ndërkohë që gjykata e cilësoi çështjen grinde për motive të dobta, ndërkohë që nuk u përmend problemi i pronësisë.

së parë, edhe Apeli vendosi që nuk ekzistonte kalimi i pronës për parcelën 6 mijë metra katrorë tek Beqir Ajazi dhe ja ka lënë në pronësi familjes së Ramiz Kapllanit.

Problemi që vijon është ai se pse nuk është ndjekur penalisht vjehri i ministres dhe noteria për këtë akt të falsifikuar, që përbën krim? Për këtë duket se ata kanë përdorur mbulimin politik nga bashkëshortja e djalit dhe vëllait të tyre Namik, pikërisht anëtarja e kabinetit qeveritar Majlinda Bregu.

KËRCËNIMI

Sipas dëshmisë së Ramiz

PYETJE PERGJIGJE

■ **Si u denoncuar ndërtimi rrëzë kalasë së Prezës?**
Banorët e fshatit kanë lajmëruar se gjatë dy javëve të fundit rrëzë kalasë po punohej për një ndërtim të ri. Kamera e A1 Report filmoi dje në vendngjarje ku duken ekskavatorët që gërmojnë.

■ **Kujt i përket ky ndërtim?**
Banorët e zonës kanë deklaruar se që në fillim aty është shfaqur ministria e Integritimit Majlinda Bregu. Vetë zëdhënësjja e ministres, pohoi dje në A1 Report se ky ndërtim i takon vjehrrit të Majlinda Bregut, por ndërtimi është konform ligjeve dhe me leje të rregullt ndërtimi.

■ **A është e lejueshme të ndërtohet pranë kalasë?**
Ligji i Trashëgimisë Kulturore, që mbrohet monumentet e kulturës, e parashihet qartë se në zona të tilla kaq pranë monumenteve për më tepër të kësaj kategorie (kala) është i ndaluar ndërtimi.

■ **Kush e ka dhënë lejen për ndërtim?**
Mësohet se leja e ndërtimit është dhënë nga ish-ministri i Kulturës Aldo Bumçi dhe drejtori i Institutit të Monumenteve Apollon Baçe.

që ky i fundit "e kish blerë" me kontratë shitjeje nr.3781/1204, datë 20.06.1997. Rezultonte që këtë shitje ta kishte bërë Ramiz Kapllani me cilësinë e përfaqësuesit të bashkëpronarëve të tjerë, me prokurë e posaçme nr.3659/1157, datë 16.06.1997.

Por, me një akt ekspertimi të datës 4.03.2011 është vërtetuar se "Nënshkrimi i plotë emër, mbiemër Ramiz Kapllani e firma në emër të tij në Kontratë Shitjeje Nr. 3780 Rep e Nr. 1204 Kol, datë 20.06.1997, përfutur nga noterja Shpresa Spahiu, nuk duhet të jetë nënshkrimi original i shtetasit Ramiz Ka-

pllani, krahasuar me modelet e dërguara në emër të tij". Për më tepër, doli se asnjë nuk i kishte dhënë të drejtën e shitjes së pronës në bashkëpronësi Ramiz Kapllanit, pasi nuk rezultoi që ata të kishin firmosur prokurën e posaçme përpara noterës Shpresa Spahiu. Ramiz Kapllani rezultoi se nuk ka shkuar fare për t'i shitur këtë pronë Beqir Ajazit përpara noterit dhe as të ketë vënë nënshkrimin në kontratën noteriale të shitjes për të konfirmuar vullnetin për tjetërsimin e pasurisë së tij në bashkëpronësi në pjesë të pandarë. Ashtu si Gjykata e shkallës

plani, krahasuar me modelet e dërguara në emër të tij". Për më tepër, doli se asnjë nuk i kishte dhënë të drejtën e shitjes së pronës në bashkëpronësi Ramiz Kapllanit, pasi nuk rezultoi që ata të kishin firmosur prokurën e posaçme përpara noterës Shpresa Spahiu. Ramiz Kapllani rezultoi se nuk ka shkuar fare për t'i shitur këtë pronë Beqir Ajazit përpara noterit dhe as të ketë vënë nënshkrimin në kontratën noteriale të shitjes për të konfirmuar vullnetin për tjetërsimin e pasurisë së tij në bashkëpronësi në pjesë të pandarë. Ashtu si Gjykata e shkallës



Tritan Shehu: Të rriten sigurimet shëndetësore, të bëhen 7 për qind

Mjeku i njohur Tritan Shehu është përfshirë në debatin për premtimin e socialistëve për shëndetësi falas. Në rrjetin social "Facebook" ai nuk ka nguruar t'u japë edhe këshilla socialistëve se çfarë duhet të bëjnë për të përmirësuar sistemin shëndetësor, por u ka sugjeruar që ta braktisin nisëm shëndetësi falas. "Dikush nga ata thotë se parimin marksist

të "shëndetësisë falas" do ta aplikojnë në 2017. Votën e morën për 2013! Pastaj, deri më 2017 unë nuk jam i sigurtë nëse ata do të jenë në qeverisje, ndoshta dhe shumë më shpejt! Megjithatë unë i këshilloj ata, se do të ishte më mirë të tërhiqen nga absurditeti, se sa të tentojnë të çmontojnë totalisht sistemin shëndetësor. Ky sistem është më i miri në themel, duhet përsosur më tej me

shpejtësi, drejt përshtatjes së plotë të tij me ekonominë e tregut. Kontributi direkt duhet rritur me shpejtësi nga 3.4% në 7%. Ne ishim më të ngadaltë se sa nevojitet dhe mundje në këtë drejtim. Sidoqoftë ftesa ime për debat me ministrin e ardhshëm të shëndetësisë, mbasi të jetë 6 muaj në detyrë, është gjithmonë në fuqi", - shkruan Tritan Shehu.

PROJEKTI

Bashkia investoi 98 milionë lekë për rindërtimin nga e para të Rrugës së Dibrës në një gjatësi prej 1385 metra linearë, që përfshinte asfaltimin, sistemin i kanalizimeve, ujësjellësit dhe futjen nën tokë të të gjithë kabujve ajrorë, vende parkimi për automjete, kors për biçikleta, etj.



NË FOTO: Punimet që po bëhen për sistemimin e kabujve të Rrugës së Dibrës

LAJMI

Rruga e Dibrës, e cila u përrua vetëm tre javë më parë, ka filluar të prishet. Investimi kushtoi 98 milionë lekë të reja, por shumë shpejt u duk se punimet në të vërtetë nuk ishin përfunduar dhe asfalti elektoral u çua shumë shpejt.

■ ■ ■ TIRANE
ESMERALDA KETA

U përrua nga Basha e Berisha më 17 qershor, kushtoi 98 mln lekë

Rruga e Dibrës mbushet me gropa

Fillojnë arnimet, pusetat ende të hapura...

Mënyra se si bëhen punimet për investimet në rrugë në Tiranë fare mirë mund të përdoret për barcaleta. Bëhet ceremonia e fillimit të punimeve, më pas bëhet një ceremoni për inspektimin e punimeve, pastaj vjen ceremonia e përfundimit të punimeve, ku politika mburret për punën e bërë. Dhe qytetarët i gëzohen rrugës së shtruar. Por më pas fillonjë e çahen trotuarët sepse nuk janë futur të gjitha linjat në tubacionet nëntokësore, ndonjëse projekti i punimeve e përcaktonte këtë. Mbyllen trotuarët, por fillon e çahet rruga pasi punimet janë bërë me shpejtësi, pusetat për kullimin e ujërave nuk janë mbyllur mirë, kabujt janë ende nëpër këmbë, etj....

Kështu po ndodh edhe me Rrugën e Dibrës, një rrugë që kushtoi plot 98 milionë lekë të reja, dhe që kryebashkiaku Basha së bashku me kryeministrin Berisha i prenë shiritin e përfundimit të punimeve 5 ditë para zgjedhjeve të 23 qershorit, pikërisht më 17 qershor. Por asfalti i hedhur në rrugën e Dibrës ka filluar të prishet. Që në hyrje të kësaj rruge, aty ku njihet si zona e Selvisë, duket qartë se firma që ka marrë përsipër rehabilitimin e një ndër rrugëve më të mbipop-

ulluara të Tiranës, ka filluar edhe arnimet. Gropat që u shfaqën vetëm dy javë pasi u pre shiriti i përfundimit të punimeve, janë rimbushur sërish. Një tregues shumë i qartë ky se si janë bërë pun-


imet në këtë rrugë. Rruga e re, e cila nuk ka as një muaj që është inauguruar, që tani është mbushur katrorë-katrorë, që janë shenjat e ndërhyrjeve për të mbyllur gropat e hapura pas përfundimit të punimeve.

por edhe duke u kthyer në një makt për qytetarët që duhet të kalojnë çdo ditë mbi pirgun e tullave. Ndërsa për nën të reja që kalojnë me karrocet e fëmijëve apo invalidët as që bëhet fjalë të

që bëjnë dje në terren, specialistët e linjave të ndryshme ende po punojnë për të futur nën tokë kabujt e tyre. Punime që kushedi sa do të zgjasin. Ndërsa pusetat e hapura janë një ndër kurthet më



Kryeministri Berisha dhe kryebashkiaku Basha në përrimin e punimeve më 17 qershor të Rrugës së Dibrës



Arnim i gropës së hapur pas përfundimit të punimeve të Rrugës së Dibrës



Pusetat e hapura në mes të rrugës së Dibrës

Edhe vijat e bardha që janë hedhur në këtë rrugë, kanë filluar e zhduken dhe kjo vetëm tre javë pas përfundimit të punimeve

E njëjta situatë vazhdon përgjatë gjithë gjatësisë së rrugës së Dibrës, që vazhdon deri te Farmacia 10. Ndërsa po të flasim për trotuarët ata janë në gjendje krejt të mjerueshme. Në pjesën më të madhe të kësaj gjatësie, ndonjëse nuk po punohet më, ata janë lënë të paplotësuar, duke lënë shkas që të prishen edhe më shpejt,

kalojnë në trotuar. Ndërkohë që, ndryshe sa u tha, kur u përrua përfundimi i rrugëve, që së bashku me asfaltimin dhe trotuarët ishte ndërhyrë edhe në sistemin e kanalizimeve dhe sistemin e telefonit, energjisë dhe të internetit, duket qartë se këto punime në të vërtetë nuk kanë përfunduar. Nga një vëzhgim

të shpeshta të kësaj rruge. Ata të shfaqen papritur, janë në mes të rrugës ku kalojnë automjetet apo në mes të trotuarit, ndërkohë që nuk ka as edhe ndonjë tabelë paralajmëruese për drejtuesit e makinave që të bëjnë kujdes. Një problem ky që në fakt rruga e Dibrës e kishte edhe para se t'i nënshtrohej rikostruksionit.

LAJME SHKURT

■ Formulari A2, plotësimi do të nisë pas 20 korrikut

Formulari A2 do të plotësohet nga të rinjtë që synojnë të zënë një vend në universitetet shqiptare pas datës 20 korrik. Edhe këtë vit ai do të jenë online dhe mendohet se atë do ta plotësojnë rreth 40 mijë të rinj. "Gjithë kandidatët të cilët janë futur në bazën e të dhënave me anë të aplikimit të formularëve A1 dhe A2 dhe nga këta, ata që kanë kaluar në të gjitha provimet e maturës. Janë 328 programe studimi. Çdo vit rritet numri i programeve të studimit" - thotë Arben Fagu, specialist në Agjensinë Kombëtare të Provimeve. Formularin A2 mund ta plotësojnë edhe ata që kanë zgjedhur të studiojnë jashtë, të cilët përafërsisht në numër shkojnë deri në 6000 kandidatë.

■ Vapa, çdo ditë 70 raste me helmime në infektiv

Ditët e nxehta të korrikut kanë sjellë dhe një fluk vizitash të pacientëve në dyert e infektivit në QSUT. Helmimi nga ushqimi është diagnoza më e shpeshtë që haset pas vizitave të mjekëve, por edhe infeksionet e ndryshme kanë qënë prezente. "Mesatarisht janë 60-70 raste në ditë. Pjesa më e madhe paraqesin helmim ushqimor ose gastro-intërite të cilat paraqiten me të vjella, dhimbje barku, diarre, temperaturë. Problematika tek moshat e vjetra është akoma më e madhe pasi ato kanë bashkëshoqëruese edhe sëmundje të tjera, siç mund të jenë diabeti, hipertensioni, problem të zemrës, të mushkërve, të cilat e komplikojnë dhe e vështirësojnë trajtimin e tyre" - thotë mjekja infektioniste Klodiana Shkurti.

■ Rriten temperaturat, e enjtja që vjen, dita më e nxehtë

Luhajlet e theksuara të temperaturës duket se do të marrin fund në 15-ditëshin e dytë të korrikut. Dje, temperatura maksimale që është shënuar në vendin tonë ka qënë 35 gradë, ndërkohë që vlera maksimale e regjistruar në Tiranë ka qënë 32 gradë celsius. Sinoptikanët thonë se pas motit të paqëndrueshëm dhe aspak tipik për stinën e verës, pjesa e dytë e muajit korrik pritet të rikthejë të nxehtin në Shqipëri. E enjtja e kësaj jave që vjen, pritet të jetë edhe dita më e nxehte e javës, sidomos në orët e pikut, në mesditë.



Paloka: Humbëm se ministrat dhe drejtorët u treguan arrogantë

Deputeti demokrat, Edi Paloka akuzon qeverinë e re se nuk do të jetë në gjendje që të mbajë premtimet e saj. Ai thotë se premtimet e së majtës ende pa ardhur në pushtet qeveria e re, rezultuan fasadë elektorale dhe jo projekte konkrete për qytetarët. "Janë mashtrimet e para që po dalin në shesh pasi ishin absurde dhe si premtime, mashtrime për ulje taksash, shëndetësi falah

heqje e TVSH. Duke përdorur variantin që nuk merren vesh me LSI tani po u dalin mashtrimet një për një", tha Paloka. Iniciativa e kryeministrit të ardhshëm për prishjen e ndërtimeve pa leje në vijën bregdetare të jugut, për Edi Palokën është një farsë, pasi sipas tij bashkitë në këto zona janë drejtuar nga e majta dhe lejet e ndërtimit janë dhënë nga vetë krerët e këtyre njësive

vendore. Lidhur me humbjen e PD, Paloka thotë se një nga shkaqet ishte dhe ministrat dhe drejtorët e pandërruar. "Këta ministra sollën pas tyre drejtorë të pandryshueshëm që krijuan një distancë dhe u bënë arrogant në marrëdhënie jo vetëm me militantët, por dhe me deputetët. Mos harrojmë se ishim në një koalicion të detyrueshëm. Por dhe emrat e deputetëve ndikojnë te qytetarët", tha Paloka.

Demokratët e jugut i kërkojnë "Ilogari" Lulzim Bashës

"Merr PD pastaj akuzo Ramën"

Basha: Bashkojmë PD vijmë në pushtet



Lulzim Basha gjatë fjalës së tij

LAJMI

Fushatën për kreun e PD, kandidati Lulzim Basha e ka shtrirë në jug të vendit, ku është ndeshur dhe me shqetësimet që ngrenë demokratët. Nga qyteti i Tepelenës, Basha ka dëgjura shqetësimet e tyre lidhur me humbjen si dhe akuzat ndaj qeverisë së re, kur ende nuk është zgjedhur kryetar.



TIRANE

ARTEMISA HOXHA

BASHA:

Ne jemi partia që shëmbi komunizmin, ne jemi partia që pas gjeneratash harrese, riktheu para shqiptarëve ideat e shoqërisë së lirë.

Për më shumë se një orë qytetarët e Tepelenës kanë dëgjuar platformën elektorale të kandidatit për kreun e Partisë Demokratike, Lulzim Basha. Në takimin e organizuar në qendrën kulturore të qytetit demokratët e shqetësuar për humbjen e thëllë që pësoi e PD-në në Qarkun e Gjirokastrës, ku arriti që të marrë vetëm një deputet, kanë pyetur lidhur me mungesën e administrimit të humbjes së zgjedhjeve apo dhe mungesën e analizës së saj. Ndonëse pyetjet kundrejt kandidatit të PD ishin pothuajse të limituara, mes të anëtarësuarve të PD nuk mungoi as shqetësimi që pse nuk mendohet për një bashkim të demokratëve pas humbjes së madhe që i ka shokuar të gjithë dhe i ka bërë më mosbesues të njëri-tjetri sesa të akuzat e Bashës ndaj qeverisë së re të Edi Ramës. "Shqetësimi ynë, që e ngritëm edhe në mbledhjen e djeshme ishte pikërisht se z.Basha foli si kreu i PD-së se do të mundte qeverinë e Ramës kur ende nuk zgjedhur si i tillë nga votat tona", shprehen burime pranë anëtarësisë së PD në qytetin e Tepelenës. Ndërkohë që në përgjigjen e tij, Basha është shprehur se "për këtë më parë duhet një bashkim i të djathtëve". Më shumë se kaq, anëtarët e PD kanë kërkuar nga z.Basha se cila do të jetë platforma e tij për bashkimin

e demokratëve, ku mësohet se Basha është shprehur "unë do të bëj bashkimin e gjithë demokratëve për të ardhur sërisht në pushtet". Ndërkohë që gjatë fjalës së tij përpara qytetarëve të Tepelenës Basha ka kërkuar mbështetjen me idenë se e djathta duhet që të luftojë kundër PS, e cila po mashtron qytetarët me

premtime si dhe po spastron administratën nga vendet e punës për të punësuar militantët e tyre. "Takimi ishte serioz nga ana e Z. Basha, por dhe nga ana e pranishmëve në sallë. Ndryshe nga takimi i disa ditëve më parë me kandidatin z.Sokol olddashi, i cili nga natyra dukej më natyrë komunikuese me anëtarët në sallë. Jemi të

dyjzuar për kë do të votojmë. I kemi të dy përzemër në PD", shprehen demokratët. Vetëm disa ditë më parë në rrethin e Tepelenës ka qenë për të shpalosur programin e tij për kreun e Partisë Demokratike, Sokol Olddashi. Takimi i organizuar në të njëjtin vend si dhe i Bashës, ka tërhequr gjithë demokratët e Tepelenës, por jo vetëm. Në zgjedhjet që do të mbahen në 22 korrik në këtë qytet si dhe në qytetet dhe komunat përreth pritet që të votojnë më shumë se 1 mijë e 500 të anëtarësuar në PD. Ndërkohë që po ditën e djeshme,

kandidati për kreun e PD, Lulzim Basha është ndalur edhe në qytetin e Përmetit, nga ku gjatë takimit me demokratët përmetarë ka premtuar programin e tij për drejtimin e partisë në Lushnjë, Peqin dhe Gramsh. Në platformën e tij për fillimin e ri të PD anëtarët dhe simpatizantët do të jenë pjesë e vendimmarrjes organizative dhe politike të partisë.

PD:

Pranuam humbjen, do mbrojmë shqiptarët

PD akuzoi mazhorancën e re se po përgatitet të mos mbajë premtimet kryesore që u bëri shqiptarëve para 23 qershorit. Zëdhënësja e selisë blu, Laura Vorpasi e konsideron qëndrimin e mazhorancës së re 'një akt të pashembullt mashtrimi në historinë elektorale'. "Disa prej tyre me kryesoret si premtimi i shërbimit shëndetësor falas për çdo shqiptar (pa kontribute të sigurimeve shëndetësore) dhe ulja e taksave për 95% të shqiptarëve, heqja e timit mbi të ardhurat personale për të gjithë qytetarët me të ardhura nën 1.5 milion lek, do shtyeshin për vitin 2017. PD e ka njohur humbjen e saj, por ajo nuk do pranojë kurrë një megamashtrim të tillë të pashembullt të qytetarëve shqiptarë", tha ajo.

Zgjedhjet

Kavaja, e paqartë mes Bashës e Olddashit, do votojnë 2600 demokratë

TIRANE

Ramazan Okshuni, kryetar i PD, së Kavajës së bashku me strukturat e degës lokale ka pritur dje pasditë në një takim kandidatit për kryetar Sokol Olddashi, ndërsa në datën 20 korrik, vetëm dy ditë përpara votimit "një anëtar - një votë" qytetin e Kavajës do ta vizitojë kandidati tjetër Lulzim Basha. "Në datën 22 korrik në Kavajë do të votojnë 2600 demokratë, sipas listave të anëtarësisë që tani janë mbyllur. Po punohet për zgjedhjen e komisionerëve në dy qendrat që do të votohet, në Kavajë dhe në Rrogozhinë, por ato ende nuk janë përcaktuar. Demokratët do të shprehen me votë për kryetarin e ri" thotë Okshuni. Por ka një specifikë tjetër Kavaja, e cila si bastion i të



djathtës për 23 vjet, humbi shumë rëndësi në zgjedhjet e 23 qershorit. Megjithatë, demokratët e Kavajës kanë më shumë lidhje me Lulzim Bashën, sepse ky ka qenë edhe i deleguari kryesor i qarkut të

Tiranës për zgjedhjet parlamentare. Basha krijoi lidhje të ngushta me strukturat e degës së PD dhe me ish nënkryetarin e dorëhequr të PD Përparim Caca. "Ne të gjithë jemi të hapur për një proces transparent dhe një garë të barabartë, ku do të ballafaqohen programet, idenë dhe iniciativat politike" thotë Okshuni. Por edhe Sokol Olddashi nuk mbetet pas. Ai ka lidhje të vjetra dhe të hershme me kreun e grupit parlamentar Astrit Patozi, me Shamatën, ish kryebashkiakun Rrugëja etj. Një pjesë e mirë e strukturave të PD kontrollohen nga këta të fundit dhe janë debate që po bëhen rëndom mes demokratëve të Kavajës. Bashës, mund t'i faturohet ndër të tjera, dhe një pjesë e madhe e fajit për humbjen e zgjedhjeve në këtë qytet, dhe lidhjeve e mospasjen parasysh të situatës me kryetarët e degëve

Intervista

TIRANE
NGA ANILA BASHA

Për moderatorin e "Opinion" Blendi Fevziu, është ngritur një thashethemnjë e tërë poshtë e përpjetë, para dhe pas zgjedhjeve. Duke qenë se ka një eksperiencë të gjatë moderimi, të gjithë fillimisht menduan se ai do t'i merrte gjithë politikanët. Por ndodhi e papritura: nuk arriti të realizonte asnjë debat PD-PS serioz, të themi në një pik-pamje. Grida Duma dhe Preç Zogaj u bënë përfaqësues të përhershëm të maxhorancës, ndërkohë përfaqësuesit e opozitës, ndërroshin hera herës. Por, gjëja më e rëndësishme që ra në sy ishte: Mungesa e Berishës. Në këtë intervistë për shqiptarja.com, Fevziu sqaron raportin e tij të munguar me Berishën, me ndërprerje telefonatash që nga janari i këtij viti; darkën e përfolur me Ramën; sherrin personal e institucional me Majlinda Bregun, por edhe nxehjen e tij të kufirit të një moderatori me Artan Lamen. Nëse Blendi është treguar i singërtë, këto janë disa prej të vërtetave që ne kemi parë në publik.

Cila është arsyeja që Berisha nuk u duk në studion tuaj, (ishite si në shtëpi për shumë kohë)?

Përgjigjen më të mirë se përse Kryeministri nuk ishte në studio mund t'ju japë vetë Kryeministri. Po, ka pasur një ngërç të tij me emisionin dhe ky ngërç lidhet me një emision të fillimit të janarit. Së paku ky është shpjegimi zyrtar që është dhënë përmes të tretësht. Unë me Kryeministrin as kam folur, as kam pasur debat dhe as kam diskutuar diçka konkrete. Thjesht një ditë komunikimi ka pushuar dhe që nga ajo ditë s'kemi folur më në telefon. Vetëm kaq. Unë vijova emisionin sipas të njëjtit stil dhe shpesh më vinte të qeshja kur pas intervistave me Ramën apo të tjerë, kolegë të mi në studio apo gazeta diskutonin si të mirëqenë që pyetjet vinin nga Berisha. Dukej qesharake, por përdërisa ata kishin vendosur të vijonin komentet në mënyrë të plotë informimi, nuk desha fare të ndërhyja. Pak njerëz që punojnë me emisionin si Lubonja, Bushati, Shkullaku, Baton Haxhiu kanë pasur djepin për atë që po ndodhte dhe të gjithë më kanë sugjeruar që të vijoja normalisht pa tensione. E fundit, besoj se Berisha kishte zgjedhur si formë prezence në publik një model që e aplikoi edhe Basha në 2011, modelin e Taun Hollit. Ky model nuk përpulhet me stilin e emisionit tim dhe unë s'mund të bëj diçka që është e imja. Nuk pranova të drejtoj as Taun Hollin e Bashës në 2011 dhe s'kisha pse negocioja me Berishën për një gjë që s'më takonte në 2013. Nga ana tjetër nëse Kryeministri vinte në intervistë, apo prezantim programi sipas modelit që zgjedha unë, ashtu siç bëri Rama, ai do të ishte i mirepritur. Në fakt asnjëherë ai nuk tha as po dhe as jo, dmth përmes ndërhyrësve, por në fund deklaroi se donte model jashtë studioje dhe me publik që pyeste. Këtu vijoi vetë...Edhe diçka. Unë kam pasur një raport kompleks pune me Sali Berishën si politikan. E kam njohur mëngjesin e 10 Dhjetorit 1990 në Qytetin Studenti, një ditë përpara se Ramiz Alia të priste përfaqësin e studentëve dhe të deklaronte pluralizimin politik; kam qenë në dhomën ku ai u zgjodh anëtar i Komisionit Nismëtar



MODERATORI i "Opinion" tregon prapaskenat e debateve para dhe pas zgjedhjeve

NË FOTO: Moderatorin i "Opinion" Blendi Fevziu dhe kryeministri Sali Berisha

Fevziu: Ju rrëfeju sherrin me Berishën

"Kryeministri duhet të flasë, por më kanë thënë se diçka ka ndodhur në një emision të janarit. Ramën në studio ma solli Baton Haxhiu. Majlinda ka qenë fotozhenike, që nga koha kur jepte lajmet. Lames, i dhashë një leksion"

të PD; kam qenë aty kur u zgjodh Kryetar Partinë në 14 Shkurt 1991! Për vite kam pasur raporte të tensionuara dhe opozitare me të dhe për vite të tjera, një raport që unë e komsideroja mjaft miqësor. Por raportin më të qoftë edhe në distancë ka ekzistuar gjithnjë. Ai është padyshim politikani më i talentuar i këtyre 23 viteve dhe njeriu që do shënjojë edhe historinë post komuniste të Shqipërisë. E kam thënë edhe njëherë, që sot e tutje ai nuk e ka raportin me ne, por me historinë. Vitet e opozitës me të kanë qenë të ashpër, vitet e miqësisë të bukura dhe padyshim që sot i vlerësoj shumë. Miqësia me të, në një farë mënyre ishte një privilegj. Por sa vlen, sa zgjat dhe kur prishet një raport miqësor, nuk besoj se kjo i intereson lexuesit. Ky është një raport personal dhe vetëm kaq!



Blendi Fevziu

Unë kam qenë vetë në një format tuajin kur flitej për gratë në politikë, dhe dukshëm nga gratë e tjeja, ju kishit zgjedhur një foto të shëmtuar të Majlinda Bregut. Pse? Çfare e ka thyer bashkëpunimin tuaj me zonjën Bregu?

Nuk besoj të ketë qenë tamam kështu. Nuk besoj që zonja Bregu të

Intervista me Ramën në 20 qershor, emisioni më i mirë i realizuar i fushatës parazgjedhore, me një intensitet të jashtëzakonshëm

ketë foto të shëmtuara. Me sa kam parë unë ajo është fotozhenike dhe kjo evidentohej që nga koha kur lexonte lajmet në televizion. Ka mundësi që atë ditë rezolcioni i fotos të mos ketë qenë i mirë. Sa për bashkëpunimin me zonjën Bregu, unë kam pasur dy probleme me të, një personal dhe një institucional. Nga ana institucionale, bashkëpunimi mediatik në zgjedhje ishte një dështim. Edhe pse përgjegjësia padyshim s'ka qenë vetëm e saja, ose ndoshta edhe unë kam pasur momente nervozizmi. Por prezenca

e PD në studio në këtë fushatë ishte pika më e dobët e kësaj partie. Një rrënim total që ajo s'e ka pasur as në referendumin e kushtetutës në 1998, zgjedhjet lokale të 2000 apo ato të përgjithshme të 2001! Zonja Bregu, për arsye mbase edhe të ngarkesës së madhe nuk përgjigjej në kohë e herë herë përgjigjet ishin arrogante. Politika dhe media janë dy pushtete të ndara, ku asnjëri nuk e dominon dot kollaj tjetrin. Iluzioni që njëri është më i fuqishëm se tjetri, është thjeshtë iluzion. Në anën personale, ka qenë një keqkuptim i imi. Unë kam besuar se me Majlindën kemi qenë miq që nga koha që ajo punonte në Klan e madje më herët. Me gjasë kam qenë i gabuar! Pas zgjedhjeve kam pasur dy - tre konsiderata disi agresive për të. Nuk dua të ketë keqkuptime. E kam ndjekur për shumë vite në politikë dhe besoj se ajo ka qenë dinjitoze, kurajoze dhe me një komunikim të mirë në publik. Besoj se këto karakteristika që nuk ndeshen aq shpesh tek politikanët shqiptarë, do ta ndihmojnë të vijojë karrierën e saj në parti.

Cili ka qenë impakti i sherrit tuaj me Artan Lamen? Pse u nxehët aq shumë duke qenë se jeni moderator i një emisioni? Përveç asaj që dëgjuaam dhe pamë?

Ajo që nuk u pa është se në pushim, pas një pjese të parë të rrëmujshme, të dy të ftuarit më kërkuar që të flisnin me rradhë dhe unë mos lejoja asnjë nga ata të ndër-

prisnin njëri - tjetrin. Kjo gjë funksionoi për sa kohë foli Lamja, por kur nisi tjetri, ai filloi ta ndërpriste. Isha i detyruar ose të ndërhyja, ose ta mbyllja emisionin. Nga ana tjetër insistova deri në fund sepse unë besoj se rregullat e lojës i vë Drejtuesi i emisionit. Arroganca e politikës që vjen dhe do të diktojë edhe në studio s'duhet të ekzistojë. Pastaj vlente edhe si shembull që mos kishte më situata të tilla dhe kur shembulli ndodh me një njeri që e ke mik dhe nuk keqkuptohesh, e bën edhe më të thjeshtë. Që mbas emisionit i kërkuam falje njëri - tjetrit me Lamen, por kur dy njerëz janë pasionantë dhe këmbëngulës, edhe ndodh.

Ka një teori se jeni bërë "rillindas". Në fakt flitet po ashtu për një darkë deri në mëngjes me Edi Ramën. Si i rivendoset raportet? Rama nuk kishte shkelur në Klan. E kërkuat ju, apo ai?

Unë s'mund të bëhem rillindas sepse s'i kam karakteristikat për të qenë i tillë! Kam rilindur një herë në dhjetor 1990! E dyta, Ramën nuk e kam sjellë unë në studion e Opinion, por ka ardhur vetë. Ai e ka pasur ftesën

Në vitin 2005 emisionin e refuzoi Fatos Nano, në vitin 2009 e refuzoi Edi Rama, ndërsa këtë vit e refuzoi Sali Berisha.

të hapur prej vitesh, por refuzonte! Këtu ka luajtur një rol edhe Baton Haxhiu që ka ndikuar në rikthimin e Ramës në Tv Klan. Madje sipas të dhënave të mia ka ndikuar në moderimin e përgjithshëm të Ramës. Rama u rikthye në Klan në Maj 2012 dhe sërish në Shkurt 2013. Muajin e fundit prania e tij e shpeshë nuk që strategji, por situatë e krijuar nga kaosi i PD. Në mes të muajit Prill axhenda e emisioneve zgjedhore ju dërgua Seliçë Blu. Në axhendë parashikohej prezantimi i programit që zakonisht bëhet nga lideri i

partisë i shoqëruar nga një staf dhe një intervistë vetëm për vetëm e Kryetarit. Kjo ka ndodhur në të gjithë zgjedhjet duke nisur që nga viti 2001. PD e aprovoi axhendën dhe më pas kjo ju dërgua PS që po ashtu e konfirmoi. Pra Rama ra dakort që të vinte për intervistë dhe për prezantim programi. 2 javë përpara mbylljes, Berisha ndryshoi mendim duke i përmbledhur të dyja në një Taun Hall. Kjo bëri që Rama të merrte më shumë kohë dhe më shumë netë në Opinion. Por më shumë se një zgjedhje e Ramës, kjo ishte një zgjedhje e Berishës. Nuk ishte hera e parë që ndodhte. Në 2005 Fatos Nano nuk erdhi në Opinion pasi e kishte konfirmuar; në 2009 Edi Rama po ashtu refuzoi të vinte; këtë vit ishte Berisha që refuzoi, pra s'është diçka e re. Sa për darkën, nuk e di për cilën e keni konkretisht. Zakonisht në Opinion, pas emisioneve të ftuarit qëndrojnë ende një apo dy orë në një kafë ose darkë post emision. Kur emisioni me Raman mbaroi në 1.35 të mëngjesit, besoj se ai ka ndenjur edhe një orë e gjysëm në një kafë me shumë vetë, dhe kjo mund të quhet mëngjes. Por me sa kujtoj unë, se s'kam qenë shumë i vëmendshëm, në të u fol më shumë për vëllimet me poezi dhe talentin poetik të Andi Bejtes. Dmth ka qenë më shumë bisedë me tematikë poetike. Zakonisht Rama s'ka folur me mua për politikë dhe që nga ajo ditë, dmth pas zgjedhjeve, s'kam pasur ndonjë kontakt me të!

Në këndvështrimin tuaj, cili ka qenë emisioni më i mirë i realizuar gjatë fushatës parazgjedhore?

Padyshim intervista me Ramën e datës 20 Qershor. Intervista filloi në 21.27 minuta për arsye të vonësës në miting dhe mbaroi në 1.31 minuta. Është intervista më e gjatë e zhvilluar ndonjëherë dhe me një intensitet që s'e prisja. Ne kontrollonim audiencën çdo 15 minuta dhe paralel me ne, në një linjë tjetër, e bënte edhe stafi i Ramës. Ajo ishte impresionuese. Sipas kalkulimit mbi bazën e matjes së Tiranes, në gjithë Shqipërinë, ajo ka pasur afro 840 mijë shikues. Ndërsa emisioni më i shikueshëm është ai i datës 26 Qershor, pas zgjedhjeve, mbremjen që Berisha dha dorëheqjen nga PD. Sipas të njëjtit kalkulim mund të kenë qenë afro 1 milion e pak shikues!

Pse deshtuan debatet politike të këtij viti?

Palët nuk qenë të interesuara për to. PS e dinte fare mirë që ishte në avantazh, kishte sondazhe të sakta dhe nuk kishte asnjë interes të përplasej me PD. Mjafton të mos gabonte që të ruante avantazhin. PD - në nuk e kuptova dot. Sipas të gjitha analizave që bëja me kolegë dhe njerëz që e njohin fushatën, PD ishte më e interesuara për debate. Ajo s'kishte rrugë tjetër të ngrihej vesce të përballte dhe mundësisht të siguronte avantazh ndaj konkurrentëve në debate televizive. Ata duhej të ishin cdo mbremje, në çdo studio, madje kryesisht në ato kundërshtarë, por me gjasë menduan se taun Hollit mjaftonin. Besoj se gabuan. Në fakt, përtej kësaj, edhe shtypi duhet të shohë diçka të stilit e tij sepse kjo fushatë tregoi që shtypi ishte shumë më pak i fuqishëm dhe influent se sa duhet të jetë.

Si po e shikon këtë periudhë të tranzitimit të pushtetit?

Nuk e kam ndjekur me shumë vëmendje për hir të së vërtetës!

RILINDASI

Viti III - Nr:28

E diel, 14 korrik 2013

Kryeredaktore: Admirina PEÇI

Na ndiqni edhe online

WWW.SHQIPTARJA.COM

OPERACIONI "APPLE"


Dokumenti sekret: Si do e rrëzonte Zogu Enver Hoxhën

AGRON ALIBALI

Emri "apple" apo "mollë" nuk lidhet vetëm me kompaninë e famshme amerikane të kompjuterave, telefonave ajfoun, etj. Rreth viteve 1950 ai është përdorur si emër-kod për një ndër operacionet e planit anglo-amerikan për rrëzimin e qeverisë Hoxha, të koduar përgjithësisht OBO-PUS/BGFIEND. dhe pikerisht, infiltrimi në Shqipëri i një grupi oficerësh të ish-Mbretit Zog për të vëzhguar gjendjen në terren dhe për të përgatitur përmbyshjen e regjimit të Hoxhës. Sipas legjendës së përhapur gjërësisht, shërbërimi i fshehtë shqiptar u njoftua për planin në fjalë prej agjentit të dyfishtë, Kim Philby, ish -punonjësi i shërbimeve britanike, i cili u kalonte informacionet shefave të tij të fshehtë në Moskë, dhe



NË FOTO: (Lart) Ahmet Zogu (Djathas) faksimile e dokumentit sekret mbi takimin e mbretit Zog me zyrtarin amerikan mbajtur në këtë hotel në 17 gusht 1951



këta të fundit njoftonin Tiranën. Mirëpo sipas studiuësit Ferdinand Dervishi, që i referohet kujtimeve të Pilo Shantos, kjo rrëfënjë është kundërshtuar më vonë nga ekspertët të Sigurimit të Shtetit, sidomos në lidhje me Radioloxhën "Liqeni Vajkal", ku sipë dihet, grupi i Zenel Shehut u kap dhe u vu në shërbim të qeverisë shqiptare për një kohë relativisht të gjatë. Sikurse sqaron me të drejtë Dervishi, grupi i Shehut hyri në Shqipëri më 1 maj 1952 në rrethin e Korçës nga kufirin grek, dhe pak ditë më vonë, më 5 maj, mbërriti në malesinë e Gramshit dhe mandej, më 25 maj, në Martanesh. Dokumentet amerikane - pjesë të të cilave ka botuar për herë të parë edhe Auron Tare - hedhin dritë gjërësisht për këtë operacion, i cili nga ana amerikane, sikurse thamë, u quajt "Apple", apo "Molla". Sipas dosjeve përkatëse të...

...vijnë në faqen 14-15

Dasmat...dhe koha ndalet në San Paolo Albanese

Një traditë plot detaje kurioze mbi ritin e dasmës në komunitetin arbëresh të San Paolo Albanese. Nga fejsa, përgatitjet për dasëm, festimet dhe traditat e shumta ruajtur me kujdes...

PIETRO ABITANTE

Rrofshi, lujlëzofshi e Rmë mos u martofshi": asnjë ngjarje e jetës shënpaljote nuk është kaq e gëzueshme dhe pjesëmarrëse se sa e dy të rinjve. Jeta "fshatare" të San Paolo Albanese karakterizohet nga pak ngjarje, por të rëndësishme, të tilla si lindjet ose festat fetare, apo të trishtuara siç është vdekja. Por është martesë, një nga eventet më të bukura dhe të artikuluar, që ndalon pothuajse kohën në komunitet, duke filluar nga rituali i fejesës deri në ditën e dasmës. Fejsa, në të kaluarën, kishte një ritual të veçantë, i dashuruar vendoste, natën vonë në pragun e shtëpisë të së

dashurës një cung druri me një sopatë të vendosur mbi të. Nëse të nesërmen në mëngjes, për fatin e keq, cungu ndodhej ende atje, kjo tregonte se propozimi ishte refuzuar, dhe në qoftë se, cungu ishte futur brenda shtëpisë kjo do të thoshte se propozimi ishte pranuar dhe fillonin negociatat për prikenë. Në San Paolo, martesë përfshinte të gjithë komunitetin. Ceremonitë tipike fillonin dy javë para: dy hallat e djalit dhe vajzës, nderonin mysafirët e tyre gjatë ceremonisë fetare dhe pritjes në mëngjes, ndërsa xhaxhallarët ose kushërinjtë kishin përgjegjësinë e organizimit të drekës së dasmës. Gjithmonë 15 ditë para vjehrra i heq...

...faqe 18-19



Gjergj Vlasi, 85 vjeç mes teatrit letërsisë dhe përkthimeve

Regjisori, shkrimtari dhe përkthyesi Gjergj Vlasi: Do të bëja 85 gjëra ndryshe... I njohur si themelues i Varietësë dhe regjisor i Estradës së Durrësit në vitin 1960, ai ka botuar rreth 40 vepra në letërsi origjinale, përkthime dhe komedi...

GËZIM KABASHI

...faqe 16-17

Arbërishtja si vetëdije gjuhësore dhe letrare

Krahas elementit gjuhë, një rol të veçantë në krijimin, ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit e ka luajtur edhe letërsia, sidomos poezia, qoftë ajo gojore, ashtu edhe ajo e shkruar, qoftë ajo e Rilindjes apo midis dy luftërave, ashtu edhe ajo bashkëkohore...

HYSNI NDRU

Gjuha dhe letërsia e arbëreshëve të Italisë janë dy elementet thelbësore që, përgjatë disa shekujve, kanë mbajtur të ndezur vetëdijen arbërore të banorëve të atyre trevave. E para, pra gjuha, duke qenë elementi kryesor që identifikon një komb, i ka dalluar arbëreshët nga i huaji/tjetri, por njëkohësisht i ka bashkuar ata vetëmeve, duke bërë që t'i mbijetojnë rrjedhës asimiluese 5-shekullore, e cila në jo pak raste ua ka rrezikuar seriozisht ekzistencën. E dyta, pra letërsia, si mjeti më anë të të cilit shkruhet, regjistrohet e gjallon një gjuhë, është zhvilluar në vazhdimësi përkrah histor-

isë e kulturës së bashkësisë arbëreshe, duke trashëguar nga paraardhësit e përcjellë të pasardhësit vlera të spikatura artistike letrare, por edhe duke ruajtur të gjallë vetëdijen e tyre etnike. Në lidhje me sistemin gjuhësor dhe letrar të shqipes, marrëdhënia e arbërishtes është specifike në disa kuptime: Së pari, arbërishtja, si vatra dhe gjuha e identitetit të arbëreshëve, padyshim është shenja më e madhe e mbijetesës dhe identifikimit të tyre. Gjuha, me gjithë nuancat dhe tiparet identifikuese të saj, u bart në vetëdijen e ikanakëve si ura lidhëse me dheun e të parëve, një urë lidhëse totale dhe e përplotësuar me të gjitha elementet e veta përbërëse...

...faqe 20

DOKUMENTET | SEKRETE AMERIKANE

Ja plani i Zogut për rrëzimin

AGRON ALIBALI

vijon nga faja 13

...deklasifikuara, nismëtar për operacionin fatkeq "Molla" ishte vetë ish-Mbreti Zog. Ishte pikërisht ai që hodhi idenë, siguroi dhe bindi njerëzit e vet që të shkonin në Shqipëri. Në verën e vitit 1951 Ahmet Zogu u ndodh për një vizitë private në SHBA. Sikurse dihet, gjatë kësaj vizite, - e para e tij në kontinentin e ri - ai bleu edhe një shtëpi në rrethet e Nju Jorkut. Natyrisht që ish-mbreti shfrytëzoi rastin për t'u takuar me zyrtarë të lartë amerikanë.

Në gjyqin special të dhjetorit 1953 të Zenel Shehut në Tiranë ky i fundit deponoi se Zogu kishte takuar në Washington Gjeneralin MacArthur, Senatorin Tufts "dhe një person tjetër". Emri i zyrtarit amerikan i cili u takua me Zogun dhe diskutoi operacionin "Molla" ende mbahet i fshehtë. Në dokumentet amerikane jepet vetëm funksioni i tij si "Chief, EE-q1", që ndofta ishte "Shefi, East-Europe, I".

Zyrtari amerikan pati gjithsej tri takime me Ahmet Zogun: i pari në Washington më 17 gusht 1951; i dyti në Nju Jork më 30 gusht 1951, dhe i treti, besojmë po në Nju Jork më 12 shtator 1951.

BISEDË E 17 GUSHTIT 1951 NË HOTELIN MAYFLOWER

Takimi ku u diskutua për herë të parë operacioni "Molla" u mbajt në 17 gusht 1951 në Hotelin e famshëm "Mayflower" në kryeqytetin amerikan, në suitën private të Ahmet Zogut. Eshhtë me interes të theksohet se gjatë qëndrimit aty, Zogu do të strehohej pikërisht atje ku kishte ushtruar veprimtarinë diplomatike për shumë vite me radhë vetë Faik Konica, Ministri shqiptar në SHBA.

Sipas zyrtarit në fjalë, qëllimi i takimit ishte për të marrë informacion dhe për të mësuar mendimet e ish-Mbretit "në lidhje me organizimin e një kryengritjeje për të përmbysur regjimin komunist në Shqipëri". Sikurse del gjatë bisedës, ky nuk kishte qenë takimi i tyre i parë, pasi të dy personazhet duket se e njihnin njëri-tjetrin, sepse diskutuan edhe interesin e përbashkët për skemën. Në bisedë, Zogu përmendi edhe "aktivitetet e tij gjatë Luftës I Botërore dhe bllokimit [detention] që u bë atij nga Perandori austriak në Vienë". Nuk mund të spekullojmë se pse Zogu iu desh të përmendte vitet e tij në Vienë gjatë kësaj bisede që do të ishte zanafilla e ngjarjeve mjaft dramatike, madje tragjike për fatin e personave të përfshirë, por sidomos për thellimin e mosbesimit në raportet e Tiranës zyrtare me SHBA-në.

Sipas raportit prej 6 faqesh të zyrtarit amerikan, ky i fundit u hodh në temë duke i thënë ish-Mbretit se "do të isha tejet i interesuar për të mësuar për idetë e tij lidhur me mënyrën më të mire për të sendërtuar një revolucion në vendin e tij". Menjëherë Zogu shprehu dëshirën e madhe për ta diskutuar këtë çështje, duke theksuar se e kishte vuarë

mendjen për një kohë të gjatë për këtë gjë dhe, "sikurse kishte përmendur në biseda të përparshme" - mënyra më e mirë do të ishte që të paraqitej si "revolucion spontan që ka plasur brenda Shqipërisë". Ai mandej përcolli një skemë të përgjithshme se si do të duhej të zhvillohej aksioni:

Së pari, Zogu mendonte se duhet "të përmirësohej dhe të ngrihej morali i popullit shqiptar", si dhe "të sigurohej neutraliteti i vendeve fqinje". Që të përmbushej kjo, Zogu kërkonte nga SHBA që (1) të deklaronin botërisht dhe vendosmërisht ruajtjen e integritetit territorial të Shqipërisë. Nëse vendet fqinje kishin pretendime territoriale, këto "duheshin bërë nëpërmjet mekanizmit të OKB-së për rregullimin e këtyre mosmarrëveshjeve"; (2) të siguronin deklaratat

nga Greqia, Jugosllavia dhe Italia ku ato të angazhoheshin se nuk do ta sulmonin ushtarakisht Shqipërinë, dhe në rast pretendimesh territorial, këto të rregulloheshin nëpërmjet mekanizmit të OKB-së.

Duket qartë se Zogu, sa ishte i interesuar për rrëzimin e regjimit komunist në Shqipëri, ishte po aq i shqetësuar për rrezikun e shpërbërjes së vendit të tij. Nëse ky shqetësim qëndronte, prapëseprapë, nuk kuptohet se pse ai përmendte "mekanizmin e OKB-së", ndërkohë që si ish-kryetar i shtetit shqiptar, duhet ta kishte të qartë se brenda Mbretërisë së tij nuk kishte patur asnjë mm katror truall të huaj.


Ndofta këtë ish-Mbreti e ka përdorur si zbulurim diplomatik i bisedës, ndërkohë që nuk përjashtohet që angazhimi i OKB-së mund të ketë qenë i nxitur edhe nga bashkëbiseduesi misterioz amerikan. Duhet të theksojmë se në asnjë rast nuk del se Zogu dhe bashkëbiseduesi i tij bisedonin me përkthyes. Duke patur parasysh se njohuritë e Zogut në gjuhën angleze kishin qenë, të mangëta, të paktën deri në largimin e tij nga Shqipëria, ka të ngjarë që bashkëbiseduesi amerikan të njihnte mirë gjuhën shqipe.

Më tej, Ahmet Zogu u përqëndrua në aspektin operacional të planit. Sipas dokumentit, përgatitje konsistonte në hartimin e planeve, grumbullimin e materialeve dhe pajisjeve ushtarake, rekrutimi i personelit që do të ndërhyje nga jashtë, dhe përgatitje e terrenit nga brenda.

"Mbreti, theksohet në dokument, është gati të marrë pjesë në çdo aspekt të operacionit, me kusht që Shtetet e Bashkuara të mbështesnin projektin."

Së pari, ai mund të planifikonte dhe ta drejtonte vetë të gjithë operacionin; së dyti, ai mund të bashkëpunonte me amerikanët për hartimin e planit dhe mund ta drejtonte operacionin me ndihmën e vëzhguesve dhe këshilltarëve amerikanë; ose ai do të pronte planet e amerikanëve dhe të punonte nën drejtimin e tyre. Sa i takon operacionin, ai mund të paraqitej si lëvizje çlirimtare shqiptare e udhëhequr nga Zogu, ose si lëvizje e udhëhequr nga Komiteti Shqipëria e Lirë, ose si lëvizje e cila do të ishte tërësisht sekrete, dhe për të cilën Komiteti do të informohej më pas. Zogu theksonte se personeli i oficerëve të tij ishte i përshtatshëm për planifikimin e duhur, dhe se ai mund të rekrutonte deri në dhjetë mijë burra po qe se do të ishte e nevojshme.

Sipas dosjeve përkatëse të deklasifikuara, nismëtar për operacionin fatkeq "Molla" ishte vetë ish-Mbreti Zog. Ishte pikërisht ai që hodhi idenë, siguroi dhe bindi njerëzit e vet që të shkonin në Shqipëri



Ahmet Zogu

Biseda në Hotelin Mayflower

Sipas zyrtarit në fjalë, qëllimi i takimit ishte për të marrë informacion dhe për të mësuar mendimet e ish-Mbretit "në lidhje me organizimin e një kryengritjeje për të përmbysur regjimin komunist në Shqipëri". Sikurse del gjatë bisedës, ky nuk kishte qenë takimi i tyre i parë, pasi të dy personazhet duket se e njihnin njëri-tjetrin, sepse diskutuan edhe interesin e përbashkët për skemën




IDEJA PËR DËRGIMIN E GRUPIT NË SHQIPËRI

Pasi të hartohej plani i përgjithshëm. "Mbreti" - sikurse i referohet Zogut bashkëbiseduesi amerikan - u shpreh se e ndjente të nevojshme të përgatiste terrenin në Shqipëri duke dërguar atje katër ose pesë oficerë. Sipas Zogut, misioni i tyre do të ishte rikonjicioni i shpejtë i vendit dhe vendosja e kontakteve në ushtri e tek disa individë të besuar. Por se cilët ishin këta individë "të besuar" dokumenti nuk përmend asnjë të dhënë. Në fakt, këtu fillon edhe drama apo tragjedia e operacionit "Radioloja" të Sigurimit të Shtetit.

Sipas Zogut, oficerët e tij mund të shpërhohej edhe nga një ose dy vëzhgues amerikanë, nëse dëshirohej një gjë e tillë. Sipas tij, njohja e gjendjes në terren do të kërkonte një muaj ose 6 javë, dhe kjo kohë do të shërbente edhe "për t'u shpjeguar detyrat në përgjithësi drejtuesve të ndryshëm brenda vendit që të ishin të qartë kur të merrnin instruksionet e duhura". Zogu shtoi se, pasi misioni i grupit të ngushtë të oficerëve të dilte nga Shqipëria, do të nevojitej rifreskimi apo rishikimi i planit, mbështetur në informata që oficerët do të kishin marrë në terren.

Zogu mandej përmendi se aspekti i pajisjes me armatim, radiokomunikacionit, dhe i transportit, do t'i lihej në dorë amerikanëve. Zogu përmendi se, që operacioni të ishte i suksesshëm, do të nevojiteshin rreth 25-30,000 burra, dhe, sipas tij, dy të tretat

e Hoxhës



NË FOTO: (Majtas) Hoteli Mayflower, në Washington DC ku u mbajt takimi mes mbretit Zog dhe zyrtarit amerikan në vitin 1951 (djathtas) faksimile të dokumentit sekret mbi takimin e mbretit Zog me zyrtarin amerikan mbajtur në këtë hotel në 17 gusht 1951

e kësaj force do të ngrihej dhe furnizohej si pasojë e "dezertimeve" nga ushtria apo sigurimi vendas. Zogu theksoi se ishte "absolutisht thelbësorë" uniteti i mbarë forcave anti-komuniste dhe se ai do të inkurajonte që të gjithë udhëheqësit në emigracion të ktheheshin në Shqipëri sapo të plaste kryengritja. Kjo do të mundësojë që këta udhëheqës të mbledhin rreth vetes të gjithë mbështetësit e tyre. Ndërkohë, të gjitha partitë politike në emigracion duhej të ndërprisnin veprimtarinë politike dhe të bashkonin përpjekjet për përmbyshjen e regjimit.

PLANI I KRYENGRITJES SIPAS FAZAVE

- Sipas Ahmet Zogut, plani për përmbyshjen e regjimit komunist do të kalonte në këto faza:
1. Deklaratat nga SHBA, Greqia, Jugosllavia e Italia lidhur me politikën e tyre ndaj Shqipërisë;
 2. Hartimi i planit operacional;
 3. Grumbullimi i armatimit dhe municionieve për 10,000 burra;
 4. Stërvitja e personelit të radiokomunikimit;
 5. Udhëtimi i rikonjicionit në Shqipëri i oficerëve të Zogut;
 6. Vendosja e një force klandestine në Greqi ose vende të tjera "prej nga kjo mund të hynte në Shqipëri". Mbreti këtu theksoi preferencën e tij që bandat të kapërcenin kufirin grek dhe, sipas tij, "bashkëpunimi i grekëve në ndërmarrjen e operacionit shqiptar ishte thujtë thelbësor".
 7. Pas plasjes së revoltës së hapur, në vend

do të hynin agentë klandestinë, Operacioni do të fillonte me disa atentate të kryera prej personash brenda qeverisë shqiptare që ishin ende besnikë të Mbretit Zog;

8. Futja në Shqipëri, nga ajri ose nga toka, e një force të vogël ushtarake shqiptare të kryesuar nga vetë Mbreti Zog dhe stafi i tij, të pasuara nga anëtarët e Komitetit Shqipëria e Lirë dhe grupe të tjera që duan të marrin pjesë në "revolucion". Në këtë fazë nga ajri do të hidhen armë për të furnizuar

Zogu mendonte se duhet "të përmirësohej dhe të ngrihej morali i popullit shqiptar". Që të përmbyshje kjo, Zogu kërkonte nga SHBA që (1) të deklarohet botërisht dhe vendosmërisht ruajtjen e integritetit territorial të Shqipërisë

njësitë guerile sipar marrëveshjeve të kryera nga agentët klandestinë paraprakisht. Priteshin po ashtu dezertime nga forcat e ushtrisë komuniste. 9. Pas përfundimit të fazës ushtarake, do të mund të fillonte veprimtaria politike e anëtarëve të Komitetit Kombëtar dhe politikanëve të OKB. Në këtë fazë, Mbreti Zog do të ftonte Tjër-Në që të dërgonte përfaqësuesit e vet për të siguruar që

formimi i qeverisë së re shqiptare të kryehej "sipas planeve demokratike".

SHQETËSIMI NDAJ BRITANIKËVE DHE FRIKA E ZOGUT

Ish-Mbreti shqiptar nuk nguroi t'i shprehë bashkëbiseduesit amerikan dyshimin e tij për rolin e britanikëve. "Në lidhje me Greqinë, shton dokumenti – Mbreti shprehu frikën se britanikët mund të kenë lidhur njëfarë marrëveshje sekrete për t'u lejuar grekëve që të pushtojnë Shqipërinë e Jugut në këmbim të heqjes dorë nga pretendimet ndaj Qipros." Ai shtoi se besonte se SHBA kishte autoritetin e duhur nëpërmjet ndihmës ekonomike që të detyronte Italinë, Jugosllavinë dhe Greqinë që të bënin deklaratat e duhura në favor të integritetit të Shqipërisë.

Zogu mandej shtjelloi idetë e tij për ngritjen e një fronti anti-komunist pan-Balkanik, duke shprehur habinë e tij për përçarjet e mëdha që kishte hasur në bisedat e tij me grupe të ndryshme politike të mërgatës jugosllave.

Në fund Zogu e njoftoi bashkëbiseduesin amerikan me një "sekret personal" lidhur me arsyet që e shtynin atë të kërkonte ndërmarrjen e një veprimi të tillë në Shqipëri në ato momente. Sipas tij, lufta midis lindjes dhe perëndimit tashmë ishte e pashmangshme, dhe duke qenë se Shqipëria teknikisht ishte në bllokun komunist, pas luftës do të përfundonte në krahun humbës. Krjedhimisht, Shqipëria do ta kishte të vështirë të ruante integritetin territorial ndaj pretendimeve të Jugosllavisë dhe Greqisë, duke parashikur se këto të fundit do të ishin kundërshtarë të bllokut sovjetik. Prandaj ai theksoi se Shqipëria duhet të ishte në krahun aleat kundër bllokut sovjetik para plasjes së konfliktit, dhe kësaj të rreshtohet në fund në krahun fitimtar, dhe jo atë humbës. Në fund, Zogu e ftoi bashkëbiseduesin misterioz amerikan ta vizitonte sërish dhe madje të ishte mik i tij qoftë në hotelin e tij në Nju Jork, ose në shtëpinë e tij në Aleksandri, Egjipt.

Koha u rrezoi parashikimet e ish-Mbretit të Shqipërisë. Edhe pse dokumenti tregon interesimin e sinqertë të Zogut për fatin e vendit, ai nxjerr gjithashtu në pah mosnjohjen e realitetit shqiptar nga ana e tij, ndofta edhe për shkak të largimit të tij 13 vjet më parë nga atdheu. Mosnjohja e Mbretit Zog si përfaqësues i ligjëshëm i qeverisë shqiptare në mërgim nga qeveria britanike gjatë Luftës II Botërore ndikoi në mënyrë thelbësore në zhvillimet e brendshme në Shqipëri pas luftimeve. Roli i tij erdhi e u venit gjithnjë e më shumë, pavarësisht nga përpjekja për t'u rikthyer në faktor në kuadrin e planeve për përmbyshjen e regjimit komunist.

Vijon...

NË 85-VJETORIN | E LINDJES

GËZIM KABASHI

Regjisori, shkrimtari dhe përkthyesi Gjergj Vlasi mbushi 85 vjeç. I nderuar me titujt e lartë "Artist i Popullit" dhe "Mjeshtër i Madh i Punës" Gjergj Vlasi është mjaft i njohur si themelues i Varietesë dhe regjisor i Estradës së Durrësit në vitin 1960, ndërsa ka botuar rreth 40 vepra në letërsi origjinale, përkthime dhe komedi.

Njohës i disa gjuhëve të huaja Gjergj Vlasi ka sjellë në gjuhën shqipe një varg botimesh me përkthime nga autorë të njohur si Franz Kafka, Jose Saramago, Agata Kristi, Dino Buxati, shkrimtarë rusë, italianë, austriakë, spanjollë, portugezë dhe hispanoamerikanë të shekullit të XX-të, etj. Librat e tij janë botuar edhe në Kosovë dhe në Itali.

Regjisori i shquar i varietesë, që jeton mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Spanjës dhe Durrësit, qytetit të tij të lindjes, në një intervistë, tregon për krijimtarinë, raportet mes regjisorit, përkthimit dhe letërsisë, si dhe për jetën e tij personale.

70 vjet krijimtari mes skenës letërsisë dhe përkthimit. A ka një "ndarje me thikë" të periudhave në keto tre fusha, sa të gjera aq edhe të lidhura me njera tjetrën?

-Nuk besoj, megjithëse ka pasë periudha kur ka mbizotëruar ndonjëra prej tyre. P.sh. Skena ka mbizotëruar, sepse kam qenë regjisor profesionist për më shumë se dyzet vjet, në fillim me amatorët e pastaj me estradën profesioniste.

Cila ka qenë puna e parë krijuese?

-Për cilën e keni fjalën, për skenën, letërsinë apo përkthimin? Nejse, po përgjigjem shkurt për tri gjinitë. Në skenë kam dalë ku isha nxënësi i shkollës fillore. Në letërsi kam qenë vjershat e para. Ato i zhdukta dhe bëra mirë se do kisha qenë poet i dobët. Këtë ua këshilloj edhe disa poetëve...

Përkthimi im i parë ka qenë tregimi "Rëfimet e një gruaje" e Mopasanit. Atë e dërgova tek gazeta e atëhershme "Bashkimi i kombit", ku u botua me pseudonimin Gje-Vla në vitin e largët 1944.

Për ata që ju ndjekin nga afër duket sikur kohët e fundit i jeni kthyer përkthimit. A i keni keputur ndonjëherë lidhjet me të dhe sa ju kanë ndihmuar gjuhët e huaja?

Vrojtimi i jemi është pjesërisht i vërtetë. Jam marrë për një farë kohe me përkthime, sidomos nga spanjishtja, se kam botuar nja an-



GJERGJ VLASHI

85 vjeç mes teatrit letërsisë dhe përkthimeve

Regjisori, shkrimtari dhe përkthyesi Gjergj Vlasi: Do të bëja 85 gjëra ndryshe... I njohur si themelues i Varietesë dhe regjisor i Estradës së Durrësit në vitin 1960, ai ka botuar rreth 40 vepra në letërsi origjinale, përkthime dhe komedi...

tologji të tregimit spanjoll të shekullit të njëzetë. Ndërkohë, kam gat një përmbledhje të re tregimesh, gjithnjë të shekullit të njëzetë. Nuk i kam shpëtur lidhjet me përkthimin dhe më pelqen që herë pas here t'i kthehem asaj pune. Kam një dëshirë: Do të më pëlqente të përktheja e të botoja "DITARET" e Kafkës, po deri tashti nuk e kam gjetur botuesin. Të shohim më vonë.

Gjuhët e huaja më kanë ndihmuar, se ato janë një pasuri e vërtetë.

Në fakt publiku shqiptar ju njih më shumë për kontributin tuaj si regjisor, megjithëse ka vite që i jeni larguar skenës. A ka pasur "divorc" mes jush?

-Unë them, jo, por edhe në pastë ndodhur ai ka qenë një "divorc" i butë, i arsyeshëm, duke iu nënshtruar ligjeve të jetës e të moshës. Vjen një kohë që edhe punës tënde më të dashur duhet t'i thuash: Mjaft! Kjo fjalë ka vlerë jo vetëm në art, po edhe në fusha të tjera të jetës. Shkurt: Bën mirë të largohesh para se të të largojnë. Lipset të shtoj se, mund të japësh ndihmesën tënde në gjini të tjera, sidomos në letërsi e në përkthime. Jo vetëm kaq, po mund të ndihmohesh edhe duke shkruar



NË FOTO: Dy libra të botuar nga Gjergj Vlasi

pjesë humoristike, madje librete për estradën, siç bëra unë para disa vitesh, që punova me estradën e Vlorës, si libretist, dhe për këtë nuk jam penduar.

Cfarë ka ndryshuar në teatrin e sotëm të estradës, goftë për të mirë apo për të keq?

-Kam ndryshuar shumë gjëra. Për të mirë, duhet të them se është krijuar Teatri i Komedisë. Kjo është një gjë pozitive.

Në ditët tona estrada ka kaluar nga skena në televizion. Kjo është një veçori e kohës. Edhe estrada i është nënshtruar një "tranzicioni" apo transformimi thuajse të plotë. Disa estrada praktikisht janë shkrirë, disa mezi mbahen në këmbë, po ndonjëra vijon ende të "mbijetojë". A thua kjo don të thotë se estrada e ka përfunduar funksionin e vet? Unë mendoj të kundërtën, por me kusht, që ajo të transformohet duke iu përshtatur kohës në të cilën jetojmë. Ky transformim nuk do të vijë nga jashtë, po atë do ta kryejnë artistët shqiptarë me lojën e tyre, me shkrimet dhe me format e larmishme.

Në çerek shekullin e kaluar keni qenë mjaft aktiv në shtypin



letrar, veçanërisht si shkrimtar i mirëfilltë dhe njëherësh si përkthyes. Ndërkohë keni dorëshkrime, që presin të botohen. Ky intensitet në krijimtarinë tuaj lidhet me daljen tuaj në pension?

Lidhet, si nuk lidhet. Megjithëse, për një artist, fjala pension është antipatike, por lipset të pranojmë se edhe për krijuesit vjen periudha e menopauzës. Është e vërtetë se kam në sirtar disa dorëshkrime që presin të botohen. Ato nuk janë "ëndrra në sirtar", po vepra të vërteta letrare, (të paktën mua, kështu me duket). Shpresoj t'i botoj sa jam gjallë, se po u botuan pas vdekjes sime, nuk e di, a thua do ta marr vesh...

Me 4 korrik bota letrare përkujtoi "fenomenin" Kafka. Në një nga komentet e shtypit po citoj këtë fjali: "Në gjuhën shqipe përpjekja e parë serjoze për të sjellë veprën e Kafkës është bërë nga regjisori e përkthyesi Gjergj Vlasi e disa perpjekje nga emra të tjerë, po ende nuk e kemi të plotë veprën e tij".

Ju miklon ky konstatim?

Patjetër. Së pari, ju falenderoj për citimin dhe më lejoni ta plotësoj me një citim tjetër të një shkrimtari. Ai thotë: "U përkthehen një tufë tregimesh të Kafkës me një gjuhë të bukur nga GJ. V.!"

Me që jemi brënda atmosferës së përkujtimit të shkrimtarit të madh, sa ka ndikuar Kafka në krijimtarinë tuaj?

Nuk besoj se ka ndikuar, se i jam ruajtur kësaj gjëje.

Kafka, bashkë me Prustin dhe Xhoisin, janë tre shkrimtarët më



NË FOTO:
Regjisori,
shkrimtari dhe
përkthyesi
Gergj Vlasi


LIBRI | I RI

Dhe malet oshtinë... Khaled Hosseini befason sërish

Një rrëfimtari mjeshtëror si Hosseini gjurmon traumat dhe dhembët e tiranisë, luftës, kimit, gënjeshtre dhe sëmundjeve në jetët e ndërlihdura, shpirtcopëtuese dhe trashendente të karakterëve të tij, për të krijuar pemën e madhe dhe gjithëpërfshirëse të jetës...

Një roman i paharrueshëm rreth gjetjes të dikush tjetër të një pjese të humbur nga vetja. Autori më i shituri në Nju-Jork, Khaled Hosseini, vjen sërish me një libër të ri pas gjashtë vjetësh. Një libër emocional, provokues dhe i paharrueshëm, që përshkruan se si dashurojmë, si kujdesemi për njëri-tjetrin dhe se si zgjedhjet që bëjmë, reflektohen brez pas brezi. Në këtë roman, Hosseini shpalos mënyrat e larmishme se si familjet mbështetin, lëndojnë, tradhetojnë, nderojnë dhe sakrifikojnë për njëri-tjetrin; dhe se sa shpesh ne habitemi nga veprimet e atyre që kemi pranë, në çastet kyçe të jetës. Duke ndjekur hap pas hapi personazhet e tij, degëzimet e jetëve të tyre, zgjedhjet dhe dashuritë nëpër botë - nga Kabuli në Paris, më pas në San Fransisko dhe në ishullin grek Tinos - historia zgjerohet duke u bërë më e ndërlikuar emocionalisht, më tërheqëse dhe më e fuqishme pas çdo faqeje që shfletojmë. Romani "Dhe malet oshtinë" fillon me rrëfimin interesant të një babai që u tregon fëmijëve të tij, Abdullait dhe Pahrut, një histori që lidhet drejtpërdrejt me udhëtimin e tyre për në Kabul, me arsyen e rreme, që i ati të gjejë një punë atje. Gjithsesi, ajo çfarë ndodh në Kabul, ndikon në gjithë pjesën e mbetur të jetës së tyre. Kështu fillon romani i tretë joshës nga autori më i shitur ndërkombëtar i romaneve "Gjuetari i balonave" dhe "Një mijë diej vezullues". Abdullah dhe Pahrui janë personazhet qendrorë të librit, po ne gjithashtu njihemi me një gamë të gjerë karakteresh shumë interesantë dhe mahnitës, historitë e të cilëve gjithashtu shtjellohen gjerësisht në faqet e këtij libri. Njihemi me rrëfimin e fuqishëm e interesant të xhaxhait të tyre, Nabi, që punon në një familje të pasur në Kabul, sa ç'është po aq tërheqës edhe historia e poetes shumë të bukur, Nilës (bashkëshortja gjysmë franceze e pronarit të tij), e mbërthyer në një martesë mbyltese e pa dashuri, si dhe me Idrisin e Timurin, dy vëllezër, familja e të cilëve u largua për në Amerikë kur filluan konfliktet. Ata u kthyen shumë vite më vonë për të ndihmuar në rindërtimin e vendit dhe të jetëve të shkatërruara. Të ngjelt në mendje tregimi prekës i Idrisit, i cili ka qëllime shumë të fisnike, por, duke mos vepruar, mbërrin në përfundime zhgënjyese për veten. Gjithashtu romani na njeh me personazhin Marko, një kirurg plastik grek, i cili punon si bamirës, si edhe me Adelin, djalin e një ish-kryekomandantit, i cili e kupton që i ati, ndoshta, nuk është ai burri i madh dhe i dashur që kishte menduar.

Një rrëfimtari mjeshtëror si Hosseini gjurmon traumat dhe dhembët e tiranisë, luftës, kimit, gënjeshtre dhe sëmundjeve në jetët e ndërlihdura, shpirtcopëtuese dhe trashendente të karakterëve të tij, për të krijuar pemën e madhe dhe gjithëpërfshirëse të jetës. "Gjuetari i balonave" dhe "Një mijë diej vezullues" e zgjeruan botëkuptimin e njerëzve për Afganistanin, duke u ofruar miliona lexuesve një përshkrim të hollësishtë dhe



Mbi autorin

Khaled Hosseini është një nga shkrimtarët më të lexuar dhe më të dashur në të gjithë botën, me më shumë se 10 milionë kopje të shitura nga "Gjuetari i balonave" dhe "Një mijë diej vezullues" në Shtetet e Bashkuara dhe më shumë se 38 milionë kopje të shitura në më shumë se 70 shtete në gjithë globin. Hosseini është gjithashtu një Ambasador i mirësisë i Komisionit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët, Agjencia e Refugjatëve UN, dhe kryesuesi i Fondacionit jofitimprurës Khaled Hosseini, që siguron asistencë humanitare për njerëzit e Afganistanit. Ai jeton në Kaliforninë e Veriut. Të drejtat e autorit janë shitur shumë përpara datës së botimit dhe do të botohet deri në vjeshtë të këtij viti, në 80 vende të botës. Libri i ri i Hosseinit është një nga të shumëpëriturit e sezonit, si nga lexuesit, ashtu edhe nga kritikët.



personal për kombin dhe njerëzit e tij. Ndërsa me romanin e tij të ri "Dhe malet oshtinë" Hosseini e ka zgjeruar shumë qëllimin dhe ambientin e tij. Duke e vendosur zhvillimin e ngjarjeve në Europë dhe në Amerikë, gjithashtu në Afganistan dhe në Pakistan romani i ri i Hosseinit ofron një këndvështrim real të lëvizjes globale, se si jetët tona ndërthuren me ato të të tjerëve dhe se si humbjet dhe mirësitë tona pasqyrohen në botë.

të mëdhenj të shekullit të kaluar, dhe do të ishte gabim i madh të ecje në gjurmët e tyre. Kështu që e përsëris. Nuk ka ndikuar, se ndikimi do të kishte qenë një karikatürë e vertetë.

Që nga romani i parë, "Njeriu i netëve të vjeshtës" kanë kaluar gati njëzet vjet. Gati po aq janë librat e tjerë, që mbajnë firmën tuaj. Cila është vepra që ju ka lodhur më shumë?

Nuk e di si të them... Një shkrimtar i shquar ka thënë: "Më mirë lodhu ti, se sa të lodhet lexuesi".

Unë jam perpjekur t'i përmbahem kesaj këshille. Nuk e di sa e kam arritur.

Gjatë këtyre viteve keni udhëtuar shumë. Përfytyrimi juaj i hershëm për botën përputhet me imazhin e vertetë të saj?

-Në disa gjëra, po, në disa, jo dhe aq.

Po e ilustruj me një shembull. Shumica jonë mendonte se Spanja është vendi i luftërave me dema apo i flamengos. Jo se kjo është e gabuar, por Spanja është një vend më i gjërë, me një kulturë e art të madh, me piktorë gjeneralë, shkrimtarë nobelistë e të tjerë.

Në Durrës ku jetoni pa nderprerje, që nga lindja, ju gmojnë për kulturën e gjërë e cilësi të tjera. Dikush thotë se e keni

lënë brenda ditës duhanin. Një tjetër thotë se keni bërë një marrëveshje me mjekun tuaj të familjes: ai ju ka ulur gjysmën e ilaçeve me kusht që të dyfishoni ecjen e përditshme?

-Ka teprime... Psh, duhanin nuk e kam lënë brenda ditës, po të nesërmen.

Ju bashkë me zonzjen Shpresë, gruan tuaj, jeni i pranishëm në shumë aktivitete. Këtë e kërkon detyrimi familjar apo qytetar? Ka ndonjë sekret për të qenë i kudon-dodhur?

-Jo. Mjafton të mbash mend datën e orën, dhe të shkosh për të respektuar dikënd, ose për të marrë pjesë në një ngjarje apo përvjetor. E thjeshtë, apo jo?

Djemtë tuaj Zefi e Floriani, në mënyra të ndryshme kanë ndjekur rrugën e artit, po ashtu edhe nipat.

Ndjejeheni i plotësuar edhe me punën e tyre?

Shumë i plotësuar. Kam vetëm një dëshirë: që të ma kalojnë!

Sapo festuat 85 vjetorin. Çfarë do të kishte bërë ndryshe në këto vite?

-Shumëçka. Nja 85 gjëra, besoj...

Falemnderit për intervistën! Ju uroj jetë të gjatë e krijimtari sukseshme!

Përkthimi im i parë ka qenë tregimi "Rrëfimet e një gruaje" e Mopasanit. Atë e dërgova tek gazeta e atëhershme "Bashkimi i kombit"

TRADITA | VLERA

Dasmat...dhe koha ndalet

PIETRO ABITANTE

Një traditë plot detaje kurioze mbi ritin e dasmës në komunitetin arbëresh të San paolo Albanese.. Nga fejesa, përgatitjet për dasëm, festimet dhe traditat e shumta ruajtur me kujdes...

Rrofshi, lujëzofshi e më mos u martofshi": asnjë ngjarje e jetës shënpaljote nuk është kaq e gëzueshme dhe pjesëmarrëse se sa e dy të rinjve.

Jeta "fshatare" të San Paolo Albanese karakterizohet nga pak ngjarje, por të rëndësishme, të tilla si lindjet ose festat fetare, apo të trishtuara siç është vdekja.

Por është martesja, një nga eventet më të bukura dhe të artikuluar, që ndalon pothuajse kohën në komunitet, duke filluar nga rituali i fejesës deri në ditën e dasmës.

Fejesa, në të kaluarën, kishte një ritual të veçantë, i dashuruari vendoste, natën vonë në pragun e shtëpisë të së dashurës një cung druri me një sopatë të vendosur mbi të.

Nëse të nesërmen në mëngjes, për fatin e keq, cungu ndodhej ende atje, kjo tregonte se propozimi ishte refuzuar, dhe në qoftë se, cungu ishte futur brenda shtëpisë kjo do të thoshte se propozimi ishte pranuar dhe fillonin negociatat për priken.

Në San Paolo, martesja përfshinte të gjithë komunitetin. Ceremonitë tipike fillonin dy javë para: dy hallat e djalit dhe vajzës, nderonin mysafirët e tyre gjatë ceremonisë fetare dhe pritjes në mëngjes, ndërsa xhaxhallarët ose kushërinjtë kishin përgjegjësinë e organizimit të drekës së dasmës.

Gjithmonë 15 ditë para vjehera i heq vëthët nuses së ardhshme, e cila do të qëndrojë pa to deri në ditën e dasmës, dhe i bën dhuratë një palë të tjera shumë të bukura dhe luksoze (shikueljt).

Tetë ditë para dasmës, dy gratë e familjes organizojnë një procesion (Vallem) që do të shoqërojë çiftin në fazat më të rëndësishme të festës dhe secila nga të ftuarat do të tregojnë fustanet e tyre gala.

Të e jnten para dasmës të së dielës, pas vlerësimit të pajës së nuses dhe përgatitjen e dhomës martesore, procesioni i dhëndrit dhe nuses bëhet veçmas, i shoqëruar me gjajde duke kënduar "kurrëxhinën": vargie ironike mbi mirësinë dhe të metat e familjeve e dy të rinjve që bashkohen.

Më pas vjen e djela e shumë prituri. Të gjithë mysafirët e nderit, këndojnë këngë polifonike për dasma si Oj, hapu malj e bënu udhë, se ka të më skonj ky zot i madh.../ Ti më ljosen me sy/ Kostandini vogëljt.

Një i afërm i ngushtë i dhëndrit, duke kërcyer, vendos flamurin e familjes në fillim të procesionit ku mysafiratë janë vendosur rresht sipas një hierarkie të përcaktuar të farefisnisë.

Flamuri është bërë me fije të veçanta (breze) që zbukurojnë rrobat e grave, dhe është qëndisur me kujdes nga duart e ekspertëve,



Në San Paolo, ceremonitë tipike fillonin dy javë para: dy hallat e djalit dhe vajzës, nderonin mysafirët e tyre gjatë ceremonisë fetare dhe pritjes në mëngjes, ndërsa xhaxhallarët ose kushërinjtë kishin përgjegjësinë e organizimit të drekës së dasmës

apostafat për të tilla raste. Një ditë para, flamuri vendoset në dritare apo në shtëpinë e atij që ka festën.

Në mëngjes, mysafirët shkojnë nga dhëndëri apo nusja për vizitë: atyre u ofrohet biskota të bëra

Tradita

Priti i jep të kafshojë tre herë dhëndërit dhe më pas nuses, biskotën tipike të ceremonisë e ngjyrë në verë, e pijnë deri në fund të gotës, dhe e hedh me forzë pas altarit në mënyrë që ajo të "shparrallohet" dhe që asnjëri askush nuk do të pijë ndonjëherë, si një shenjë e besnikëri të përjetshme. Më pas vazhdon një "shëtitje", liturgjike, njohur si Valëzimi i Ngazëllimit, në të cilën, prifti, nusja dhëndëri dhe dëshmitarët, largohen nga altari

për rastin. Ndërsa për të bërë nderimet është një xhaxha ose një i afërm, i cili qeras me verë, ku mbahet në një enë prej argjile të madhe (kënata).

Pastaj, nga shtëpia e nuses, një grup mysafirësh shkojnë dhe marrin dhëndërrin dhe duke u bashkuar me të ftuarit e tjerë, e shoqërojnë atë në shtëpinë e nuses.

Më pas nusja e veshur me vello të bardhë, në momentin e ardhjes së krushqve qan për largimin nga shtëpia.

Babai në pragun e derës përshëndet dhëndërin duke i kërkuar "Do nuse o skëmandilj?" - Don nuse apo shami?

Dhe përgjigja është:

Donja nuse e skëmandilj!" dua nuse dhe shami

Dhe kështu vjeherri, vendosos shaminë tek xhepi i xhakotës.

Një i afërm i shëndrit hyn në shtëpi dhe fton nusen për ta ndjekur duke i ofruar një shami prej tyli duke i thënë tre here:

"Ngreu, nuse/ ulju nuse!" - Ngrehu nus, ulu nuse.

Dhe në fund thotë

"Po ngreu, ti nuse, e nga me ne, se këtu ti s'ke më hije- ngrehu o nuse dhe hajde me ne pasi në këtë vend nuk ke më rol dinjitoz.

Nusja shoqërohet nga dy xhaxhallarët për krahësh në rrugën drejt kishës.

Vetëm në kishë çifti mund të takohen, dhe ajo merr krahun e dhëndërit, ndërsa dëshmitari i parë i zgjidh lidhëset e këpucës së majtë, pasi meqëse ende nuk kanë lidhur kurorën, të dy thonë njërit tjetrit para dhe të disa dëshmitarëve.

Në kishë pastaj ritin i kurorë-



zimit i cili është sipas atij bizantin. Dy kurora të bardha me lule të vogla të bëra me grep, japin rrezatim dhe lavdi të sapomartuarve dhe kryqëzohen tre herë mbi kokat e tyre nga prifti dhe pastaj të gjithë dëshmitarët i urojnë mbarësi.

"Rrofshi, lujëzofshi e më mos u martofshi!", Jetë të gjatë, Lulëzofshit dhe kurrë mos u martofshit.

Më pas dhurohen unazat, që jepen nga prifti, edhe ato kryqëzohen 3 herë, dhe vendosen në gishtin e unazës në dorën e djathtë. Vetëm më vonë, dhe për zakon unaza e dasmës vendoset në dorën e majtë.

Priti i jep të kafshojë tre herë dhëndërit dhe më pas nuses, biskotën tipike të ceremonisë e ngjyrë në verë, e pijnë deri në fund të gotës, dhe e hedh me forzë pas altarit në mënyrë që ajo të "shparrallohet" dhe që asnjëri askush nuk do të pijë ndonjëherë, si një shenjë e besnikëri të përjetshme.

Më pas vazhdon një "shëtitje", liturgjike, njohur si Valëzimi i Ngazëllimit, në të cilën, prifti, nusja dhëndëri dhe dëshmitarët, largohen nga altari.

Në dalje, dhëndërit i lidhet lid-

në San Paolo Albanese

Dashmet, Shën Palj

“Rrofshi, lujëzofshi e më mos u martofshi”: s’është mos një evend i katundit aq i bukur e i gëzuar sa ai kur dy të rinj martohen.



Dasmat

Kjo traditë e bukur dhe unike është vetëm një nga diversitetet kulturor të shumta që Italia është kaq e pasur dhe ajo kurrë nuk pushon së mrekulluari dhe ku një ishull i vogël i gjuhës shqipe si ajo e Shën Palit gjen një rol të pamendueshme

hësja e këpucës si shenjë e dhënies fund të beqarisë dhe respektit dhe besnikërisë ndaj partneres së saj.

Kështu korteu dasmor vazhdon në drejtim të shtëpisë së dhëndërit. Gjatë rrugës këndohen këngë dasmash si llaci i rrëgjëndi / Hapu malj e bënu udhë / Dolla ljar tek një breg / e të tjerë.

Në prag të shtëpisë “Nusja” pritet nga vjehrra që i reciton vargje me rimë (kënkëkën) lavdata dhe nga ky moment e thërret nuse për të gjithë jetën dhe asnjëherë me emër.

Më pas është dreka, kur një herë e një kohë, nga ajo që tregon Ruzina Garrubës, përbëhet nga një menu me perime, makarona, dhe mish të kafshëve të rritura për rastin e madh, ndërsa pjatat dhe pecetat e duarve merreshin hua dhe riktheheshin të pastra.

Ditën tjetër, vjehrra pasi të ketë kontrolluar shtratin në kërkim të “shenjave të integritetit moral” të nuses, fton për drekë vetëm të afërmit e saj urdhëron që festa të vazhdojë me vallëzime dhe këngë deri natën vonë.

Vetëm të martën e ëma e nuses i fton krushqit e rinjë për të festuar martesën, celebruar dy ditë më parë, madje edhe në shtëpinë e tij, me një drekë bujare, muzikë dhe këngë.

Të djelën e ardhshme, vjehrra shoqëron nusen në kishë dhe e nderon duke i ofruar vend në stolin e familjes. Ajo çfarë ndodh në vazhdim i përket të përditshmes!

Kjo traditë e bukur dhe unike është vetëm një nga diversitetet kulturor të shumta që Italia është kaq e pasur dhe ajo kurrë nuk pushon së mrekulluari dhe ku një ishull i vogël i gjuhës shqipe si ajo e Shën Palit gjen një rol të pamendueshme.

Jeta “katundare” shënpaljote ka pak momente sinjifikative: të gëzuarë, si ata kur ljehet kishteri o festat të shëjta e ata me heljem kur njerzit vdesen. Po ai çë, më se të tjerët, dhja sikuna e qëndron motin, është matrimoni me festat të bukura çë bëhen bashkë, tue zënur fill ka shkuqia njera ditën e dashmvet.

Shkuqia, me parë, bëhej ndryshe: burri kumbisnej, natën te baljaturi nuses, një bukur kucur druri i thertur ka topra; ndë,largu kjoftë, manatën pas, ai ish adhe atje si e kish lëshuar, doj me thënë se shkuqia nëk bëhej; kurse, ndë kucurin e kishin vënë mbrenda, doj me thënë se fëmijla nuses kish thënë “E” e mënd të tratohej për paljën.

Shën Palj, dashmet përzienjën gjithë gjinden e Katundit. Festa zë fill ngapu dy javë: dy emta, një e nuses e një e dhëndrit venë shpi më shpi për të invitatur më kljishë e për manaten e festës, kurse ungljit e kushrinjt invitarnjën te tryesa.

Pesëmbëdhjetë ditë më parë e vjehrra ia nxier vëthët të resë që qëndron pa njera të dielën kur të veshet nuse me shikueltj çë i jep ajo për rriall.

Tetë dite para dashmvet, dy gra ka ana dhëmdrit venë tue thirrur për vallen: çdo grua vritet për ti bënj nder dhëndrit e nuses me ljiweret më të bukura çë ka. Pas mbidhën më shpi e bënjën taraljet me undir e mraj të egër.

Të ënjtën, pas çë kanë parë shtratin të shtruar, vallja nuses e vallja dhëndrit, nga një për kundin e tyre, venë për katund me karamunxa e surdulina tue kënduar kurrëxhinën: këndohen maganjat e të dy fëmijave;

Pihet, me taralje, një qelq më shumë e rrëfehen të mirat edhe të ljiगत të nuses e të dhëndrit.

E vjen e diela dashmëve. Gratë me skëmandilje me franxhë zënë valle e me dy burra në kryet dy anëvet çë këcenjën, tue bëre ih... ih...ih... shtien vjeshe dashmje si Oj, hapu malj e bënu udhë Ti më ljosen me sy/ Kostandini vogëljith e më të tjera. Një gjiri i parë i dhëndrit, tue këcier, tunden fljamurin mbi këshet e gravet të valles. Fljamuri është i bëre me brëzet e ljiweret të gravet ka ana dhëndrit e vëhet ditën më parë tek dritësorja e shpisë së dhëndrit.

Manatën spëndohën taralje e verë. Një ungelj o një gjiri i parë i dhëndrit mass verën te muzulnërat me një stjavuke tek mushku manxhin. Pas vallja nuses niset e vete merr dhëndrin. Bashkë me vallen e dhëndrit venë ka nusja ku gjënjën derën e mbyllur e gjirit e dhëndrit shtijnë ata të nuses njera kur të hapet e bënjën faka do te rëmbënjën nusen.

Mbrënda shpisë nusja, e haljmuar pret me jëmën të ikenjë ka shpia ku u rrit; ajo është gati e stuljisur me cohë, stjep e dy parë spingulla, kurse i ati saj qëndron dhëndrin përpara derës e i thot: “do nuse o skëmandilj”

E dhëndri i përgjegjet: “donja nuse e skëmandilj” E ashtu, tue i vënë skëmandiljin tek buxha gunës, i jep biljë e paljë.

Atëherë një i fëmijës hyn më shpi e me një skëmandilj tull çë i ndën nuses, i thot për tri herë:

“ Ngreu nuse, ulju nuse”

E ljujtëmu:

Po ngreu, ti nuse, e nga me ne, se këtu ti s’ke më hije”

Niset nusja, me dy të ungelj e çë marrën nënkrah, vete më kljishë, një e emëtë e mba te mesi e ajo do të ia shin buzën kur të përvojë taralji e qethur. E te dera kljishës merr për krahu dhëndrin, kurse kumbari i parë i zgjidh lacin e këpucës manxhine (burri nëk u ljid adhel) e përpara Zotit e të gjithë kumbaret thonë atë “EN” aq i pritur.

Më kljishë vënë kurorë. Është momenti më i bukur i rritit bixantin: dy kurora ljujleje të bardha japën glorje e bukuri kopjes. Më merr zoti e pëstajna kumbaret ia ndronjën te kryet e tyre për tri herë, tue thënë:

“Rrofshi, lujëzofshi e më mos u martofshi!”

Pas ndrohën unazat, edhe ato për tri herë, tek dora djathtë pëstajna shkronja jetra. Priti i jep të hanë taraljin të qethur të ngjier tek vera e i jep të pinë verën te qelqji: atje ku zë ajin dhëndri ka të zër aj nusja e atje ku vë buzën dhëndri ka te verë nusja ashtu çë mos të shihenën njera të jetrit e zoti

e pljasen qelqjin përtrolli prapa autarit ashtu çë mos njiri më piftë atje.Thënka ndryshe, dy kurme bëhen një në emërin e Tënzoti!

Para se të daljën mbrënda kljishës dhëndri e nusja bënjën një xhir me zotin e kumbaret ndëpër navatat: është udha e jetës me të mirat e të ljiगत çë do të shkoniën ashtu si i shkoj Krishti.

Nje herë përjashta kljishës kumbari i parë ia ljidhen lacin e këpucës dhëndrit çë i kish zgjidhur kur hyqin, vjen me thënë se nuses ka ti ketë risjpet. Hapet vallja njatër herë me vjeshe dashmje, Llaci rrëgjëndi/ Hapu malj e bënu udhë/ Dolla ljar tek një breg, merr kopjen e venë të shpia tij ku, te praku derës, e vjehrra pret nusen e me një kënkëkë i këndon sa më të mira mend ti thet e do ti thres nuse për gjithë jetën e jetës saj.

Nani hahet te ristorandi, po më parë, ashtu si e rrëfen Ruzina Garrubës, hahej te shpia dhëndrit: ljakra me ljiğent mishi, tumacë citra e mish kafshje. Grepat, ljugazit e mësallat mirrshin hua. Hahej e ljuhej njera mbrëmanet. Natën “përtaret” adhe dhëndri me serenata ndën dritësorës ku është e fljë “ëmljith, ëmljith” me nusen e njera sa të ngrëhet e ti ofrir një qelqj verë.

Të hënëen manat, një herë, thënka pljakat e katundit, e vjehrra shtronej shtratin tue kërkuar “provat” e drejtësisë së resë. Pas i thrris të gjithëve gjurivet e tyre e hahej, këndohej e ljuhej njatër herë njera natën. Fëmijla e nuses nëm mënd të mirr pjesë te dashmet: kush kish faqen të mirr pjesë, burrë o grua, ish i përqeshur për katund. Vetem të marrën, jëma nuses bënej festë e i thërris dhe krushqvet .Dashmet mbyllën të dielën pas kur jëma dhëndrit vete më kljishë bashkë me të renë e i jep llokun te bangu i fëmijës saj.

Kështu shuhet çdo lligri e vjen e ngaditë! Këto zakone të bukura buthtonjën sa ndryshe e sa bëgate me kulturë është Talia, ku rrolli i madh çë gjën një katund i vogël si Shën Palj, bën marviljë.

Pietro Abitante



Intervista

PROJEKTI Së bashku me një grup specialistësh kemi hartuar një program shumë të mirë të sportit, që mendoj se do t'i shërbejë vërtetë ringritjes së sportit dhe funksionimit të tij cilësor

FIDEL YLLI

Jam i gatshëm t'i shërbej sportit në çdo pozicion

LAJMI

Deputeti i PS, Fidel Ylli dhe njëherësh një nga njerëzit më të apasionuar për sportin në Shqipëri në një intervistë për 'Shqiptarja.com' rrëfen programin për rilindjen e sportit. Fidel Ylli është kandidat potencial për Ministrinë e Sportit, pasi shkohet si shpresa e fundit e shumë sporteve, pasi janë rënuar totalisht.

TIRANE

DYLBER BALLA

Në prag të formimit të qeverisë së re Fidel Ylli shprehet se PS ka gati programin për ringritjen e sportit në Shqipëri duke premtuar rikthimin në kohët e arta.

Si është gjendja reale e sportit në Shqipëri?

- Gjendja reale është për të ardhur keq. Në mjerim total. Për të qenë realistë nuk pritëm ardhjen e kryeministrit të ri, por me mbështetjen e kryetarit të Partisë Socialiste, sot kryeministri i ri ne e kemi bërë auditimin e sportit, pasi prej dy vjetësh kemi shkëlur të gjithë Shqipërinë. Ne e kemi një pasqyrë reale të gjendjes së sportit dhe dimë me detaje, të gjitha problematikat, vështirësitë, e njëkohësisht zgjidhjen e tyre.

Ndaj nuk do të presim plotësimin e 300 ditëve të para të qeverisjes për të bërë bilance, por që në ditën e parë ne do të fokusohemi me përkushtim për të vëmë në zbatim programin tonë, me të cilin njerëzit e sportit janë njohur prej dy vjetësh, nëpërmjet fushatave tona intesive dhe shumë të frytshme, në të gjitha vendet ku flitet shqip.

Kush nga sportet në Shqipëri është në gjendjen më të rëndë?

Nuk bëhet diferencim, këtu nuk funksionon i tërë sistemi dhe nuk mund të flasim në detaje, për sporte apo disiplina sportive, kur e gjithë struktura nuk është funksionale, nuk i shërben sportit.

Ne do të ndryshojmë bazën ligjore, duke futur frymën e bashkëpunimit me biznesin privat, që të mos kthehen në ndërmarrje shtetërore me 100% të kapitalit nga bashkëtitë

Kush do të jetë hapi i parë që do të hidhet për sportin?

Ne hapin e parë e kemi hedhur, për herë të parë në këto 23 vjet demokraci, kemi arritur të fusim sportin në axhendën politike. Partia Socialiste e Shqipërisë dhe kryetari i saj Edi Rama kanë arritur ta fusin sportin në prioritet e qeveriasjes së re, në programin e tyre, duke hartuar të parin program të mirëfillt për sportin. Një program i shkëlqyer, i bërë nga specialistë më të mirë në vend dhe me një mbështetje dhe konsultim shumë profesional ndërkombëtar.

Cfarë do të bëhet me buxhetin për sportin, pasi edhe Kosova e ka më të lartë?

Hapi i dytë i rrigëtitimit tonë do të jetë rritja e buxhetit për sportin, që nëpërmjet të ardhurave dytësore, më konkretisht nëpërmjet kompanive të bastëve dhe llotarisë kombëtare ne do të rrisim ndjeshëm buxhetin dhe investimet. Dhe me një

mënyrë më eficiente dhe të përgjegjshme do të manaxhojmë këto buxhete për t'i vënë në shërbim të sportit dhe njerëzve të sportit, duke vënë të gjithë mekanizant në efencencë të plotë.

Si e komentoni faktin që disa federata janë shndërruar në ndërmarrje shtetërore?

Disa federata sportive janë kthyer në ndërmarrje shtetërore. Ne do t'i japim pavarësinë dhe statusin të gjitha federatave dhe do të rrisim dhe shtojmë format e bashkëpunimit për mirëfunksionimin e sportit.

Shumë klube futbolli kanë përfunduar në rrugë, për shkak të mungesës së privatizimit, cfarë do ndryshojmë me qeverinë e re?

Ne do të ndryshojmë bazën ligjore, duke futur frymën e bashkëpunimit me biznesin privat, që të mos kthehen në ndërmarrje shtetërore me 100% të kapitalit nga bashkëtitë.

Si e gjykon faktin që paratë publike përdoren shumë pak për infrastrukturën sportive që është krejt e amortizuar?

Këtu mungon vizioni për të ndryshuar. Në 22 vjet nuk janë bërë investime, sepse kanë munguar partnerët dhe donatorët, të cilëve nuk u janë krijuar kushtet për të bashkëpunuar. Ndaj një hap i rëndësishëm është baza ligjore, e favorshme për bashkëpunimin me biznesin dhe donatorët. Duhet patjetër bashkëpunimi me partnerë dhe donatorë nga biznesi, pa ndihmën dhe kontributin e të cilëve nuk mund të arrihet ringritja, funksionimi dhe manxhimi më i mirë i sportit. Kërkohe frymëzime bashkëpunimi dhe një vizion i ri.

Ajeni dakord me idenë me të cilin ka funksionuar pushteti vendor, për financimin e sportit më elitare?

Ne nuk jemi kundër investimit për sportin elitare

nga bashkëtitë. Ne duhet të investojmë në burime njerëzore, infrastrukturë, bazë ligjore, që sporti të bëhet me themele të fortë. Dhe investimet do të jenë të gjithanshme dhe për sportistët elitare.

Kush do të jetë veprimi i parë, pas tjetërimit të terreneve që janë bërë pa masë?

Do të stopojmë fillimisht rrënimin, degradimin e këtyre ekzistues. Kemi bërë një inventar në të gjithë Shqipërinë, se ku do të nisim punën me terrenet e rënuara, nga Kukësi në Sarandë, për të gjitha terrenet, palestra, fusha, pallate sporti, e gjithcka tjetër.

A do të jenë të rinjtë në qendër të mbështetjes nga projekti i ri?

Ne në këtë program na bën më shumë optimistë fakti që i janë bashkëngjitur pjesa më e madhe e rinisë, që në rrugëtimin tonë për paraqitjen e draftit, na kanë kërkuar për të qenë prezentë, për ta shpalosur programin tonë ambicioz. Pra do të jenë patjetër pjesë integrale e të gjitha projekteve tona të sportit.

A është e mundur idea e krijimit të ligës mbarëkombëtare, e hedhur nga kryeministri në ikje?

E parë nuk është idea e tij, pasi ne prej 2 vjetësh kemi nisur negociatat për krijimin e ligave mbarëkombëtare, të cilat funksionojnë edhe me mbështetjen e ndërkombëtarëve. Pra mund të bëhen fillimisht disa liga mbarëkombëtare, të cilat i lejojnë edhe organizmat ndërkombëtarë, si partnerët tanë më të mirë. Liga e Berishës, ishte një shashkë, për të turbulluar ambientin, duke ngritur hamendësime dhe paragjikime. Bashkëpunimi me Kosovën do të jetë një nga prioritetet më të mëdha të programit tonë për sportin. Është një pjesë shumë e rëndësishme.

Si do të veprohet për parandalimin e dhunës dhe trukimeve?

Ne do të kemi tolerancë zero për dhunën dhe trukimet. Po ju them që tani që do të ketë dorë të hekurit për dhunën. Do të ndërhyet në kodin e procedurës penale. Sa i përket trukimeve do të zbatohet ligji, me të gjithë forcën e tij, në bashkëpunim të ngushtë me ndërkombëtarët dhe të gjithë të mbajnë përgjegjësi ligjore.

Presidenti i FSHP ka thënë se do të ketë ndjekje penale për ata që rezultojnë me doping, ju si do të veproni?

Kjo është një sipërmarrje që nuk bëhet me urdhra dhe deklarata presidentësh. Kërkohe një ligj i mirë dhe institucione funksionale, të përgjegjshme, si komisioni i antidopingut kombëtar, i cili duhet të jetë i pavarur dhe mbi të gjitha funksional, me mjekë dhe specialistë, të cilët në bashkëpunim me ministrinë dhe federatat të kryejnë kontrolle të befasishme, në prag të aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare. Është një handikap që do të rregullohet shumë shpejt nga qeveria e re.

Komenti juaj për gjendjen e peshëngritjes dhe Begajn që kërcënon me largim?

Më vjen keq që sporti më elitare në Shqipëri, për të cilin dëgjojmë sportistë që kërcënojnë me largim: historia e kërcënimit për largimin e sportistëve do të përfundojë. Këta sportistë janë idhuj, janë imazhi më i mirë i këtij vendi dhe do të trajtohen si ikona, të cilët nuk do të shfaqen në media duke u lutur për paratë që meritojnë, por të ndihen të vlerësuar dhe trajtuar nga shteti. Ndaj u jap shpresë të gjithëve, që shumë shpejt kjo histori do të marrë fund.

A egziston sporti i mundjes në Shqipëri realist?

Mundja është i vetmi sport që ka nxjerrë kampionë botë. Elis Guri, Seit Prizreni i treti në botë, Petro Strugji që ka qenë kampion që në 1920. Ky është sporti i traditës dhe jo vetëm mban peshën e sportit elitare, por i vetmi që ka afruar edhe biznesmenët, si Krenar Luto, që falë pasionit ka ngritur ekupe private, me sportistë të talentuar dhe me shumë të ardhme për këtë sport në vendin tonë. Kjo është mundja, sporti

Ne do të kemi tolerancë zero për sa i përket dhunës dhe trukimeve. Po ju them që tani që do të ketë dorë të hekurit për dhunën. Do të ndërhyet në kodin e procedurës penale

elitare, që ndoshta edhe media duhet të jetë më afër, e të mos pasqyrojë vetëm ndeshjet e trukuara në kupat e evropës.

Duke qenë se jeni njeriu i vetëm në PS por edhe në Shqipëri që keni folur me zemër për sportin dhe e dini se ku i pikon çatia, jeni gati të merrni përgjegjësinë për të drejtuar Ministrinë e Sportit nëse Rama ju propozon?

Së bashku me një grup specialistësh kemi hartuar një program shumë të mirë të sportit, që mendoj se do t'i shërbejë vërtetë ringritjes së sportit dhe funksionimit të tij cilësor. Një program i detajuar, shumë profesional, i bërë me pasion dhe shumë dashuri. Zgjedhja e Ministrit është çështje politike, që i takon kryeministrit Rama. Unë jam i gatshëm t'i shërbej sportit, në të gjitha mënyrat, sic e kam bërë dhe vazhdoj ta bëj çdo ditë.





Koment

Në kohën e gabuar?



NGA AFRIM KRASNIQI

vijon nga faqja 1

...gjerman kjo nuk mjafton, madje sjell rritim. Ai të sjell shembullin e të disa deputetëve të rinj në Elbasan, në Tiranë, në Lezhë, në Shkodër, dhe në Fier, të cilët të pyetur prej tij në ditët e fushatës mbi përmbytjet e Kodit Zgjedhor dhe Kushtetutës i ishte përgjigjur pothuajse me të njëjtën gjuhë: nuk është puna e jonë të lexojmë ligje e libra. Do kenë staf për këtë punë. Ata vetëm sa do kujdesen që të paguajë një stafë të mira. Ndaj hulumtimi i tij ndalon tek pyetja e raportit të shqiptarëve me librin, me dijen, me vlerat, me meritat dhe me sensin e përgjegjësisë. Sot kur rikthejmë kokën në histori dhe kujtojmë ditët më të vështira dëgjojmë të thuhet: Esat Pasha nuk dinte të shkruante shqip, firmoste me gisht; Haxhi Qamili kishte urretje ndaj dijes; as Zogu, as Enveri dhe as Alia nuk mbaruan shkolla të larta të plota, K.Xoxe ishte këpuçar dhe urrente intelektualët, H.Lleshi dhe një turmë drejtuesish të tjerë ishin pa shkollim cilësor, etj, etj. Dhe mund të jenë 100% të vërteta. Por që mund të thonë shumë për ne, jo për ata. Sepse princin perëndimor dhe shqiptarin më të arsimuar i dëbuan brenda 6 muajsh nga pushteti, sepse elitën e arsimuar të viteve 30-40 e detyruan të emigrojnë ose e dënuan përpara togës së pushkatimit, sepse institucionet fetare me rol thelbësor në formësimin e dijës kombëtare i mbyllën dhe i shndërruan në magazina e qendra sportive! Vendin e mendimtarëve e zuri modeli i njeriut të ri, bujkuat të dalluar që u bë deputet, mjekësës së dalluar që u bë sekretare e Komitetit Qendror, karrocierit të dalluar që u bë anëtar në Byronë Politike, shoferit të dalluar që u bë zv/kryeministër! Rezultatitë dihet, falimentim fatali sistemit, i shtetit, vlerave shoqërore dhe burimeve njerëzore e kulturore.

Më 1990 erdhi shansi historik, kur për herë të parë një elitë politike do të vinte nga auditorët akademikë dhe universitarë. Shumica e atyre që u vendosën në krye të partive të djathta e të majta gëzuanin arsimim cilësor, madje të dërguar nga regjimi në universitete perëndime kur qytetarit të thjeshtë shqiptar kjo i ndalohej me kushtetutë! Ata premtuan një sistem të ri vlerash, që funksionoi ca kohë, më pas

pjesërisht dhe që mori fund tërësisht brenda 6-7 viteve të para të pluralizmit politik. Ngjarjet e vitit 1997 deformuan cilësinë e përfaqësimit, tek të gjitha palët politike. Vendin e elitave e zuri "qendrestarët", "militantët", të cilët u zgjodhën dhe rizgjedhën në parlament, qeveri dhe poste të larta drejtuese me shumë se një herë.

Më 2001 socialistët premtuan pa sukses meritokracinë, më 2005 PD e rimori këtë temë fillimisht me sukses, më 2009 u fol u harrua tërësisht dhe sot, më 2013 jeta politike heq dorë konsensualisht nga sistemi i meritës dhe vlerave përfaqësuese. Etja e madhe për rotacion politik nga njëra anë dhe etja e madhe për qëndrestarë memecë e besnikë nga ana tjetër çoi në produktin më pak cilësor përfaqësues të 22 viteve pluralizëm. Nëse shihen pjesa e prurjeve të reja parlamentare të krijuar përshtypja se nuk kemi zgjedhur parlament, por jemi zgjedhur shoqatën e biznesit të lojërave të fatit, shoqatën e biznesit të ndërimit, shoqatën e shkollës së ri-edukimit, pra një produkt tranzicioni, paasnjëlidhje organike me prishmëritë dhe nevojat e mëdha që ka shoqëria dhe shteti shqiptar.


Është folur shumë për emrat e veçantë dhe CV e tyre të pasur në raportet me organet e drejtësisë jo vetëm në Shqipëri. Është folur shumë për dyndjen e biznesit poli-

tik në fushata dhe në krye të listës së partive politike, siç është folur shumë për rezultatet surprizë të shit-blejve të votave, zgjedhësve, komisionerëve, medieve, etj, para dhe gjatë fushatës elektorale. Të gjithë folën, me përjashtim të prokuroresë, KQZ-së, drejtorisë së tatimeve, të doganave, të pastrimit të parave apo të interpolit. Ata duhet të kenë pasur arsyt e tyre, natyrisht jo ligjore.

Në këtë klimë zgjedhore e politike qytetarët morën pjesë masive në votime dhe me votën e tyre vendosën se kush do t'i përfaqësojë në katër vitet e ardhshme. Kur sovranin flet nuk ka diskutim – thuhet në politikë, dhe parimisht kjo sentencë vlen. Siç vlen edhe përmbytja cilësore e fjalës së sovranit! Ai e tregoi në formën më të ashpër zhgënjimin e tij me politikën qeveritare, ndaj arrogancës së pushtetit dhe sistemit piramidial të kryeministrit ende në detyrë. Dhe shkoj për ti rëzuar me votë masive, me 1 milion vota. Për këtë sovranin meriton respekt, siç meritoi më 1992 apo 2005 kur rotacioni erdhi për palët e tjera politike. Por për pjesën tjetër, kur një pjesë e sovranit vendosi ta shkëmbejë symbyllurazi apo me para besimin e pushtetit e vet kushtetues – nuk ka shumë vend për respekt, sa ka vend për refleksion dhe alarm në krizën e identitetit, mendimit dhe kulturës politike të shoqërisë shqiptare. Asnjë motiv imirëpoli-

tik nuk është arsye e mjaftueshme për të votuar e mbështetur kandidatë skandalozë në listat elektorale! Asgjë nuk përbën alibi të besueshme për të zëvendësuar një sistem arrogant politik me një sistem përfaqësues nën mesataren e inteligjencës publike. Gjë që ndodhi. Dhe sot shteti shqiptar hyn në shekullin e ri shtet-formues me parlamentin më pak cilësor, më pak të ndershëm, më pak dinjitoz dhe përfaqësues sesa çdo parlament tjetër të periudhave të zgjedhjeve konkurruese.

Fama është e shkurtër, turpi jeton gjatë – thuhet në raste të tilla edhe kur bëhet falë për një jetë të pushtetshëm nga të cilët, nuk është sekret, duket të kemi frikë. Sepse përveç pushtetit të parave dhe forcës sot u kemi dhënë edhe pushtetin politik, legjislativ dhe ekzekutiv. Ata do zgjedhin gjykatësit, kryeprokurorin, kryekontrollorin, presidentin, kryeministrin, ministrat dhe do të miratojnë ligjet me ndikim me jetën, lirinë dhe sfiat tona në katër vitet e ardhshme! Ata nuk lexojnë libra, nuk lexojnë ligje, por kanë pushtet e lidhje që u lejojnë të kthejnë në shërbëtorë të synimeve të tyre media e universitete, krijues publikë në krizë identiteti dhe grupe të shumta kientale, folklorike e populiste që mbijetojnë duke kërkuar



padronë të rinj për tu shërbyer. Kolegu gjerman ka të drejtë: tek ne ende shihet si fajtor dhe i huaj nëse thua që merrem me libra dhe botë akademike, tek ne fatkeqsisht nuk ka vlerë fjalë dhe as kontributi publik, nuk kanë më vlerë vendimet morale dhe as ndershmëria profesionale. Sepse ne ndodhemi në krizë identiteti shoqëror, në krizë të vlerave morale dhe sistemit të meritës, në krizë përfaqësimi dhe reagimi. Ndaj midis të gjitha alegjive një numër i madh qytetarësh zgjodhën rrugën më të shkurtër, mbështetjen e produktit më dinjitoz të sistemit të turmave dhe tranzicionit, -një klasë të re politike, që nuk është aty për politikë dhe as ligje, për programe zhvillimi dhe as projekte integruese, por për veten, miqtë, familjen, shefat, biznesin, partnerët, imunitetin, statusin social dhe garancinë e mbajtjes në këmbë të sistemit të pashal-

larëve, - i rrezuar formalisht nga shqiptarët rreth 100 vjet më parë.

Cila është zgjidhja? Nëse do flisja për zgjidhje afatgjata do të imitoja të gjitha këshillat e rilindësve më shumë se një shekull më parë apo elitës intelektuale të viteve 30-40. Receta është e njëjtë pavarësisht viteve dhe rrethanave. Në planin afatshkurtyr zgjidhje do të ishin institucionet e garancisë publike: institucionet kushtetuese përballë produktit populist e klientelist të turmës, institucionet ligjore përballë turmës që kërkon imunitet përballë ligjit, institucionet e edukimit demokratik përballë kioskave universitare të pushteteve, institucionet e demokracisë direkte përballë pazareve klienteliste të qdo pushteti, institucionet e partive politike demokratike përballë partive-piramida personave të kryetarëve të radhës, institucionet e reagimit civil përballë ofertës së heshtjes, institucionet e presionit të jashtëm për reforma përballë presionit të brendshëm për të mos ndryshuar, ndryshim thelbësor në Kodin Zgjedhor, në sistem përfaqësues kushtetues, në raportet midis shtetit dhe pushtetit të radhës, si dhe presion pozitiv të përditshëm ndaj fituesve e humbësve nominalë të zgjedhjeve për tu ndarë nga bota informale e përfaqësimit, për transparencë në vendimmarrje, për hapësira reale ndaj prurjeve të reja elitare dhe universitarë, mbështetje të gazetarisë së pavarur, medias investiguese, mekanizime të kontrollit dhe sistemit efektiv të drejtësisë.

Ky vend, kjo shoqëri, këta miliona njerëz evropianë të ndëshkuar në vite nga udhëheqësit e tyre nuk mund të jenë përjetësisht të lindur në kohën e gabuar. Ata mund të kërkojnë shans dhe shpresë, besim dhe inspirim, - gjë që politika nuk mund tua ofrojë, por të paktën ata meritojnë një qeverisje normale, demokraci normale funksionale, shtet normal që përipiqet të ndryshojë, politikë normale që mendon edhe për qytetarët, pra meritojnë diçka ndryshe nga oferta e përhershme e zhgënjimit. Sepse, duke cituar Presidentin Obama në adresimin e ambasadorit të tij Arvizu mbi Shqipërinë "ndryshimi nuk vjen nëse presim për një tjetër person ose për një tjetër kohë. Ne jemi ata për të cilët kemi qenë në pritje. Ne jemi ndryshimi që kërkojmë".

Koment

Kush e trazon gjumin e përjetshëm?



NGA ERION KRISTO

vijon nga faqja 1

...këto tashmë nuk janë vendi i prehes së përjetshme, por shkas për pasurim. Qeveria e re duhet ta ketë në vëmendje të saj këtë çështje, për ta trajtuar me përparësi. Dhe këtu nuk ka asnjë shaka. Le të kujdesemi për "të shumtët", pastaj për të paktët. Këta të fundit do ta kuptojnë, sepse askush ndër ne nuk ka dëshirë t'i trazohet banesa e fundit, ajo që na kthen në gjirin e Krijuesit. Dhe duhet ta shohim me kujdes këtë sektor, sepse gjithmonë duhen zgjidhjet e mëdha, reformat e mëdha.

Në këtë pikë nuk duhet të bëhemi me turp për ngjarjet e rënda, si në Korçë apo Sarandë tash së fundi, sepse grabitja e varreve përveçse e njohur në aspektin filmik, është e njohur historikisht që me grabitjet e

varrezave të faraonëve. E për ta bërë pakëz më të gjerë problemin, të mos harrojmë se zhvarrime t'i koncept janë thellë brenda nesh: zhvarrime të diktaturës, zhvarrime pas diktaturës, riatdhesime kockash, madje themelim varrezash me kocka të huajsh që tranzitojnë sa nga një vend në tjetrin për të mos gjetur paqe. Dhe një është bërë shpesh pre e nevojës për të trazuar kocka. E ka shkruar Kadare me përpikëri, në një roman të tërë, të vlerësuar dhe ndërkombëtarisht. Shpesh kujtohen fqinjët për kocka të parësh, tretur gjithandej, për të na i valëvitur si kuaj modernë Troje. Po kjo është një histori më vete, gjithësi e lidhur me faktin se ne nuk kemi një strategji kombëtare për trajtimin e asaj çka mbetet së mbriani nga njeriu. E për t'u kthyer ndëshkimeve, edhe ndryshime në Kodin Penal duhet të parashikohen: gjoba dhe dhëmit deri në 5 vjet nuk mjaftojnë për të ndaluar furinë e njerzëve të etur për të grabitur. Duhet ta ketë edhe krimi një kod nderi, që nuk e paska realisht.

E për të mos mbetur vetëm të shteti, që është një faktor i vetëm, duhet të kërkojmë dhe nga mekanizmat shoqërorë të tregojnë vetëpërmbytje. Rugëtimi i fundit i njeriut duhet të jetë një udhëtim pa bagazhe, i lehtë. Familjarët e lënduar



nga humbja e jetës së të afërmit, nuk duhet të bëjnë gabimin të krijojnë tundime duke shpallur përpara botës fuqinë financiare, sepse fuqia financiare vetëm në strehën e fundit s'ka më asnjë kuptim. Le të flasim faraonët që u grabitën edhe pse përdornin lëndë radioaktive për të mbrojtur luksin e tyre. Gjithashtu vetëpërmbytje kërkohej që të mos zihet hapësira publike duke u dhënë varrezave një pamje që nuk duhet ta kenë: personalizim. Bota e përtejme nuk e njeh fodullëkun dhe është pikërisht e kundërta. Po lumsi ata kombe që mësuuan nga gabimet e tyre dhe të pararendësve të tyre.

PARADE FJALEKRYQESH

INGIA Kadri Vokopola



FJALEKRYQI SPORTIV

HORIZONTAL

- Cahill te Chelsea.
- Personazhi në foto.
- Roddick tenist.
- Bie fiks.
- Një cigan.
- Ulivieri, trainer italian.
- Mendohehen shumë për të lëvizur.
- Fillojnë romanin.
- Është klub i... fakultetit.
- Njëlljo për latinët.
- Shabani i volejbolit tonë.
- Një Gjika që luante me "Labinotin".
- Fazat pa kufji.
- Djeg nostalgjikun.
- Ami i Maupassant.
- Mbyllin një sirtar.
- Personazhi në foto.
- Janë në modë.
- Marion Jones.
- Gjysma e farsës.

VERTIKAL

- Një top në rrjetë.
- Fillojnë argumentin.
- Mund të jetë shënim.
- Mund të jenë dy ose katër në motor.
- Është i shtatë me kinemanë.
- Parashtesë për kundër.
- Ndez në ekstreme.
- Ajo e boksit është me një gisht.
- Francesku kantautor.
- Një mund të jetë me shtatë.
- Ekstreme në ekstreme.
- Gjysmë humbje.
- Satirë pa zë.

- Emri i Sivori-t.
- Në fillim të shekullit.
- Fillojnë daljen.
- Thurman aktore.
- Ndërrohet me zapping.
- Serena, që që bomber italian.
- Me carpe në një shprehje latine.
- Bull në skuadrën e Vettel.
- Ekstreme në litar.
- Bjorn ish-tenisist.
- Është i pastër në mal.
- Magritte piktor.
- Një ekip i Kretës.
- Një pjesë e agjenturës.
- Në mes të dhomës.
- Fyen pa fe
- Mbyllin portat.
- Në krye të grupit.
- Qendër mesimi.

PËRGJIGJA E FJALEKRYQIT SPORTIV

FJALEKRYQI PA SKEME

DUHET TË NXINI 32 KUTI

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17
1																	
2																	
3																	
4																	
5																	
6																	
7																	
8																	
9																	
10																	
11																	
12																	

HORIZONTAL

- Shteti i francezëve.
- Ashtu si nuk rri zevzeku.
- Mund të jenë në natyrë.
- Tipat pa ekstreme.
- Trihati ish-volejbolist.
- Hoëard regjisor.
- Rrjedh në Klepsidër.
- Janë punëtorë... për marksisistë.
- Është sëmundje veshëshe.
- Një në virtual në computer.
- Gjysmë rekord.
- Luftojnë për ata që i paguanjë.
- Elizabeth Taylor.
- Film i Alfred Hitchcock.
- Brother në Top Channel.
- Institucione Doganore Rajonale
- Qe centauri që mësonte Akilën.

VERTIKAL

- Janë garat me gregarë
- Janë si tatami.
- Një që s'ka vullnet e dëshirë.
- Kështu fillon titulli
- Titulli i Hiri-Hitos.
- Admir mbrojtës i yni.
- Janë edhe ato polare.
- Magritte piktor.
- Iniciale e Ravel.
- Një si minder.

VERTIKAL

- Pak enigmatike.
- Tony që thirret Mister Quando.
- Tapeti për judo.
- Mbyllin fushatat.
- Një motokaf gare.
- Ente Kombëtare Autonome.
- Janë veladonë.
- Një Tv... me X Factor.
- Janë penjtë për gjergjef.
- Gironë aktor.
- Thahet me bonifikim

- Një mund të jetë machiatto.
- Fare pa fe.
- Janë zonat e kufizuara.
- Ishte anija me flamur të zi.
- Shkroi Në jetë e Jezusit.
- Janë baballarët.
- Jepen me leksione.
- Është pluhuri si Dash.
- Këndon Sie io non avessi te.
- Mbledh basket separatiste.
- Një si nofke.

PËRGJIGJA E FJALEKRYQIT PA SKEME

I KRIPTOGRAFUAR

SHKRONJA E NJËJTË PËR NUMËR TË NJËJTË

5	10	6	13	5	10	8	11	2		
13	5	12	18	14	2	4	6	2	11	3
18	11	5	3	5	11	6	7	3	5	3
2	18	12	12	8	6	3	18	13	13	6
4	13	2	18	4	2	4	5	12		
9	2	8	13	2	12	18	3	2	7	
8	2	3	2	3	5	7	6	1		
6	1	5	11		9	6	12	15		
14	2	4	3	2	18	4	2	11	6	
2	15	4	6		15	2	12	5	1	
11	1	3	3	12	2	11	9	6	13	
6	11	2	7	5	4	10	2	4	4	2

PËRGJIGJE E NUMRIT TË KALUAR

HOROSKOPI

DASHI
Ala që janë në një lidhje prej disa kohësh do marrin vendime shumë të rëndësishme mbi të ardhmen sot. Do i dëgjoni ato që do iu thotë tjetri dhe në asnjë mënyrë nuk do vendosni vete. Beqaret do jenë me të hapur dhe do përfitojnë nga ftesat që do iu bëhen.

DEMI
Me në fund do dilni nga veshitë dhe keni pasur në jetën tuaj në çift dhe do jeni me optimiste për të ardhmen se bashku. Mirëkuptimi do jetë një pikë e forte. Beqaret do vazhdojnë të jenë në kërkim, por nuk do arrijnë ta gjejnë personin e dëshiruar.

BINJAKET
Jeta sentimentale do jetë prioritet për ju sot. Do dini të kërkonti fjalë për gabimet që keni bërë dhe toleroni me shumë. Edhe ata që kanë pasur probleme serioze do mundohen t'i sqarojnë gjatë. Financat do jenë delicate kështu që tregohuni shumë të matur.

GAFORRJA
Jeta juaj në çift do jetë me prioritet për ju sot. Do dini të kërkonti fjalë për gabimet që keni bërë dhe toleroni me shumë. Edhe ata që kanë pasur probleme serioze do mundohen t'i sqarojnë gjatë. Financat do jenë delicate kështu që tregohuni shumë të matur.

LUANI
Jeta sentimentale e çiftëve nuk do jetë aq e qete sa ata mendonin. Urani do ndikojë negativisht dhe do iu shtyjë të tregoheni me kokëfortë se kurrë. Beqaret do kenë flirte me shumicë me persona interesante. Në planin financiar duhet të bëni çmos të stabilizoni situatën.

VRIGJËRËSHA
Do ndiheni shumë mire pranë atij që dashuronit sot dhe do flisni qetësisht për të ardhmen. Edhe ai iu do po aq sa ju dhe dëshiron me gjithë zemër të kalojë jetën me ju. Beqaret do kenë disa takime, por do jenë të pavendosur të zgjedhin. Për planin financiar do jetë dile e qete.

ESHORJA
Dialogu do mbizotërojë gjatë gjithë kësaj dite në jetën tuaj në çift. Nuk do lini asnjë t'u a prishe harmoninë dhe në mbrëmje do e surprizoni partnerin. Beqaret nuk duhet ta presin sot personin ideal sepse njëjditës i jor nuk është fort i përshatshëm.

AKREPI
Te ndihmua nga Merkuri do e mahnitni partnerin tuaj sot. Do tregoheni shumë me të hapur dhe do e toleroni me tepër raste. Edhe ndërgjatë ditës do dashuronit. Beqaret do jenë me humor të mirë dhe do tregohen të hapur ndaj njëjtit të reja. Mos jepni as hua sepse situata nuk është aq e qëndrueshme.

SHIGJETARI
Mos u dekurajoni edhe nëse keni kontradiktë me partnerin tuaj sot. Te gjithë çiftet kanë debate here pas here, por merita juaj do jetë nëse do i kaloni ato sa me shpejt dhe pa u lënduar shumë. Beqaret nuk duhet të nxitohen, por t'ia lenë kohës gjithçka.

BRICJAPI
Nëse doni që lidhja juaj të shkojë sa me mirë duhet të mos e ndërprisni për asnjë moment komunikim. Kimin dhe të ndihmoni njëri-tjetrin me tepër. Beqaret nga ana tjetër do kenë një takim shumë të rëndësishëm i cili do ua ndryshojë përgjithmonë të ardhmen.

UJORI
Asnjë planet nuk do ndikojë gjatë kësaj dite në jetën tuaj sentimentale dhe gjithçka do varet nga sjellja juaj. Tregohuni pak me të hapur ndaj propozimeve që do iu bëjë partneri. Beqaret do jenë shumë të angazhuar me punë dhe nuk do kenë kohë për t'ia kushtuar jetes sentimentale.

PESHQIT
Dito mjaft e bukur kjo e sotmja për të dashuruarit. Do bashkëpunoni për gjithçka me partnerin tuaj dhe dita do jetë akoma me sensuale. Për beqaret do ekzistojnë mundësi reale për të krijuar lidhje, kështu që ata duhet të përfitojnë sa me shumë që të mundin.

SUDOKU

	3	2	7	8		6		
2			5	4				3
		4		9	7			
6	8			5			4	7
7	3	6		2	8			1
4	2			8			9	6
		2		1	6			
3			9	5				8
5		4	3	6		2		

PËRGJIGJE E NUMRIT TË KALUAR

LAJME
NGA BOTA

■ "New York Times": Thaçi ka shanse për Nobelin

Gazeta amerikane "New York Times" i ka dedikuar një artikull në numrin e djeshëm kryeministrit të Kosovës Hashim Thaçi, duke e cilësuar si një ish-luftëtar dhe komandant të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që aspiron të kujtohet si një burrë shteti. Sipas kësaj gazete, Brukseli dhe Uashingtoni ai konsiderohet si "Gerry Adams" i Ballkanit, që po e çon vendin drejt Evropës dhe emri i tij po përmendet, madje, sado e pamundur të duket, edhe si kandidat për Çmimin Nobel të Paqes. "Kam luftuar në anën e drejtë të historisë për të çliruar popullin tim nga tirania kundër një armiku të pamëshirshëm që bënte përpjekje për kryerjen e një gjenocidi masiv," është shprehur Thaçi në këtë intervistë.

■ SHBA: Ushtria të lirojë ish-presidentin Morsi

Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës u ka bërë thirrje autoriteteve egjiptiane të lirojnë ish-presidentin Mohamed Morsi, i cili ka qenë në arrest shtëpie që kur trupat egjiptiane e hoqën nga pushteti javën e kaluar. Sipas zëdhënësës së Departamentit të Shtetit Amerikan, presidenti Morsi duhet të lirohet, në kuadër të përpjekjeve për të përfshirë të gjithë aktorët politikë në një qeveri tranzicioni, duke përmendur këtu edhe Vëllazërinë Myslimane të Morsit. SHBA po analizojnë ende ngjarjet në Egjipt për të vendosur nëse rrezimi i Morsit ishte grusht shteti. Një përkrahim i tillë është me rëndësi dhe mund të rezultojë në anulimin e mbi 1 miliard dollarëve ndihma amerikane për Egjiptin.

■ Burg për ministrin e parë rumun në detyrë


Ministri rumun i Transporteve Relu Fennec u dënua me pesë vjet heqje lirie, pasi një gjykatë në Bukuresht e shpalli fajtor për korupsion dhe shpërdorim të detyrës. Fennec është ministri i parë rumun që dënohet ndërsa është ende në detyrë. Në vitin 2003, në rolin e një sipërmarrësi të fuqishëm, Fennec drejtoi një grup kompanish që nuk përmbushën kushtet e kontratës në disa tendera të fituara, duke i shkaktuar shtetit një dëm prej miliona eurosh. Nëpërmjet këtij vendimi, Bukureshti shpreson që t'i tregojë Brukselit se është duke ndjekur hapa konkretë kundër korupsionit.

■ Arabët, thirrje për kujdes ndaj virusit MERS



Autoritetet shëndetësore në Arabinë Saudite u kanë kërkuar pelegrinëve që vizitojnë objektet e kultit me rastin e Ramazanit që të vendosin maska në ambientet e populluara, me qëllim pengimin e përhapjes së virusit MERS. Një listë me kërkesa e lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë u sugjeron personave në moshë me sëmundje kronike që të shtynë pelegrinazhin e tyre. Të paktën 38 persona kanë vdekur nga virusi MERS në Arabinë Saudite, ndërkohë që miliona mysliimanë nga e gjithë bota pritet të marrin pjesë në pelegrinazhin e tetorit. Organizata Botërore e Shëndetësisë deri tani ka konfirmuar 80 raste infektimi dhe 44 raste vdekjeje në mbarë botën.


■ SHBA akuzojnë Moskën se mbështet dezertorin

Shtetet e Bashkuara akuzuan Rusinë se po i jep ish-nëpunësit të CIA-s Edward Snowden, njeriu që bëri publike informacionet sekrete amerikane, "një platformë propagande". Presidenti Barak Obama i telefonoi kreut të Kremlinit Vladimir Putin pas takimit të Snowden-it me grupet e të drejtave të njeriut në aeroportin e Moskës. Kjo ishte dalja e tij e parë publike prej mbërritjes në kryeqytetin rus nga Hong Kongu. Presidenti rus e ka bërë të qartë se nuk do ta ekstradojë 30-vjeçarin në SHBA. Ndërsa dje kryediplomati rus Sergei Lavrov tha se autoritetet ruse nuk janë në kontakt me ish-kontraktorin e SHBA-së.



abissnet
INTERNET SERVICE SOLUTIONS



6Mbps
x 3 muaj = **5,500 lekë**
x 6 muaj = **10,000 lekë**
x 12 muaj = **19,000 lekë**

Për të gjitha parapagimet 3 mujore paketa kushton vetëm 5.500 lekë
Për të gjitha parapagimet 6 mujore paketa kushton vetëm 10.000 lekë
Për të gjitha parapagimet 12 mujore paketa kushton vetëm 19.000 lekë
Oferta është e vlefshme për paketën 6 Mbps

Vizitoni dyqanet tona ose faqen e internetit www.abissnet.al

• Alba Malltezi
Drejtoreshë e Përgjithshme
e Free and Fair Media Group

• Anila Basha
Drejtoreshë e Shqiptarja.com

• Edmond Arizaj
Kryeredaktor

• Genc Kondi
Zv. Kryeredaktor

Politika: Jakin Marena

Aktualitet: Granit Sokolaj
Ekonomia: Genc Kondi
Social: Esmeralda Keta
Kulturë: Admirina Peçi

Design: Altin Aliaj
Genti Manelli

Website: Suela Gera

Departamenti i Marketingut:
Cel: +355696060419
marketing@shqiptarja.com

Shpërndarja:
Saimir Zenelaj
cel: +355696060418
cel: +355696088847

Redaksia: Rruga "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë-Tiranë. E-mail: redaksia@shqiptarja.com - Website: www.shqiptarja.com - Mobile: +355696060421 - Shtypur në shtypshkronjën: A.K shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë